



CHILD PROTECTION HUB
FOR SOUTH EAST EUROPE
WWW.CHILDHUB.ORG

**Studimi fillestar mbi identifikimin e praktikave
për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe
nevojat e stafit përkatës
në Shqipëri**



Projekti “Platforma për Mbrojtjen e Fëmijëve në Evropën Juglindore” mbështetet nga fondet e Agjencisë Austriake të Zhvillimit, Bashkimit Evropian, Terre des hommes dhe Fondit Kanton Zürich Lottery



Informacioni dhe qëndrimet e publikuara në këtë raport janë të autores dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian. Si Bashkimi Evropian ashtu edhe institucionet e tij ose personat që veprojnë në emër dhe për llogari të Bashkimit Evropian nuk mbajnë përgjegjësi për mënyrën sesi përdoret informacioni i përfshirë në këtë studim.

Publikuar nga Platforma për Mbrojtjen e Fëmijëve, Janar 2016



**STUDIMI FILLESTAR MBI
IDENTIFIKIMIN E PRAKTIKAVE
për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe nevojat
e stafit përkatës
në Shqipëri**

Dr. Elona Dhëmbo
TdH Shqipëri, Shtator 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE	5
II. RISHIKIMI I LITERATURËS	7
Mbrojtja sociale në Shqipëri – një panoramë e përgjithshme	7
Kuari për mbrojtjen e fëmijëve.....	8
Kush po i mbron fëmijët në Shqipëri? – Profesionit i Punës sociale	9
Arsimimi për punën sociale në Shqipëri.....	11
Një panoramë e arsimimit në punë sociale.....	11
Kurrikula e Punës Sociale.....	11
Kërkimi	13
Politikat	14
Praktika	14
Edukimi i vazhdueshëm edhe ngritja e kapaciteteve për stafin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve	15
III. METODOLOGJIA	16
IV. REZULTATET	19
Panorama e punonjësve të shërbimit social: perceptimet dhe kuptueshmëri mbi punën sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri	19
Perceptimi dhe kuptimi i punës sociale	19
Perceptimet dhe kuptimi i mbrojtjes së fëmijëve.....	21
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore: kualifikimet & mjedisi organizativ	22
Arsimimi: kurrikula, kërkimet, politikat, praktika	23
Kurrikula.....	23
Kërkimet.....	27
Politikat	28
Praktika	29
Aftësitë, njohuritë dhe interesat gjatë praktikës së mbrojtjes së fëmijëve	31
V. KONKLuzionET	33
VI. REFERENCA.....	35
VII. SHTOJCA.....	37
1. Formulari për miratimin e informuar	37
2. Udhëzues gjysmë i strukturuar për intervistën.....	38
3. Udhëzues për diskutime në fokus-grupe	41
4. Ushtrim për arritjen e konsensusit	45

I. HYRJE

Ky studim fillestar, që identifikon praktikat për mbrojtjen e fëmijëve dhe nevojat e stafit në këtë fushë, fokusohet tek Shqipëria. Gjatë dekadave të fundit, Shqipëria (një shtet i vogël i vendosur në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si dhe demokraci e re që hyri në ekonominë e tregut në 1990, pas rrëzimit të një prej regjimeve më të ashpra diktatoriale komuniste¹) është përpjekur të ecë me ritme të ngjashme me vendet e tjera të Evropës. Progresi ekonomik gjatë periudhës së tranzicionit e ndihmoi vendin të ngrihej nga një vend me të ardhura të ulëta në një vend me të ardhura të mesme të larta (Banka Botërore 2015). Megjithatë, probleme të varfërisë (Shqipëria mbetet një nga tre vendet më të varfra në rajon) dhe pabarazive socio-ekonomike vazhdojnë të sjellin një sërë problemesh dhe nevojash shoqërore për një numër grupesh vulnerabël (Cabiri et al, 2015.)²

Proceset e vazhdueshme reformuese në sektorin ekonomik, edukimit, kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale nuk kanë qenë të mjaftueshme për të rritur aftësinë e qeverive që t'i përgjigjen siç duhet nevojave të grupeve vulnerabël, përfshirë fëmijët të cilët përbëjnë më shumë se 35% të popullsisë në moshë të re. Mbi 20% e fëmijëve jetojnë në varfëri të plotë (21.4 % në zonat rurale), 49.6% e familjeve me më shumë se katër fëmijë janë të varfra dhe 22% e fëmijëve nga 0-4 vjeç jetojnë në varfëri (MMSR, 2014; Gedeshi & Jorgoni, 2012). Në këtë kontekst, fëmijët në rrezik janë një nga grupet vulnerabël të identifikuar dhe targetuar edhe nga Strategjia Kombëtare për Përfshirjen Sociale (NSSI) (MMRS, 2015). Pavarësisht përparësive së dhënë në nivel politikash, prej mëse tre dekadash (që prej 1993), programi i ndihmës ekonomike mbetet skema kryesore për uljen e varfërisë, duke mbuluar vetëm 23% të familjeve tejet të varfra. Krahas kësaj, 90% e shërbimeve janë të vendosura në zonat urbane (MMRS, 2015) ndërsa për shërbimet në komunitet Shqipëria vazhdon të mbështetet shumë tek organizatat jo-qeveritare (OJQ) (Qendra për Studime Sociale, 2013), kapaciteti i të cilave për të ofruar shërbime sociale ka ardhur në ulje si pasojë edhe tkurrjes së fondeve nga donatorët.

Si rezultat, jo të gjithë fëmijët dhe familjet në nevojë janë të mbuluar dhe mbrojtur plotësisht. Përkundrazi, shumë kategori fëmijësh janë në rrezik për siguri në dhe zhvillimin e shëndetshëm (si fëmijët në lëvizje, fëmijët që nuk janë regjistruar në lindje, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e ndarë nga prindërit, dhe fëmijët që ju përkasin pakicave minoritare, janë disa prej tyre). Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin e Qeverisje Lokale 2014-2020 krijon mundësi të reja për zhvillimin e ndërhyrjeve dhe shërbimeve të përshtatura sipas zonës, të cilat janë më afër grupeve të interesit dhe nevojave të tyre, por edhe sfida sesi kjo do të mund të materializohet pas një historie të gjatë përpjekjesh të pasuksesshme për reforma decentralizimi në të shkuarën (Ministria e Shtetit për Qeverisjen Lokale, 2014).

Nga ana tjetër, tendenca globale për të rritur mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi, dhuna dhe neglizhimi, si dhe për të mbështetur familjet nëpërmjet një qasjeje më të integruar dhe sistematike (Canavera, Akesson, & Landis, 2014) ka prekur edhe zhvillimet lokale në Shqipëri (Maestral, 2015)³. Kalimi drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse nënkupton edhe një shkallë më të lartë përfshirjeje dhe rol më pro-aktiv nga ana e aktorëve të ndryshëm gjë që sjell edhe nivele të reja shqetësimi për qartësinë e tërësisë së roleve dhe nivelet e kapaciteteve të burimeve njerëzore të përfshira.

Në një kontekst ku mundësitë dhe sfidat e procesi të decentralizimit dhe ato të qasjes së re sistematike në shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve (dhe ato sociale në përgjithësi) mbivendosen, qendra e gravitetit zhvendoset gjithnjë e më shumë drejt zhvillimit të forcës së punës për shërbimet sociale dhe gatishmërisë për t'ju përgjigjur këtyre ndryshimeve. Qasjet dhe reformat e reja do të përkthehen në zbatim nga një numër i madh profesionistësh të disiplinave dhe sektorëve të ndryshëm. Duke qenë se qasja për planifikimin dhe zbatimin e shërbimeve po bëhet gjithnjë e më shumë e mbështetur tek sistemet dhe decentralizimi, stafi i departamenteve dhe niveleve të ndryshme qeveritare si dhe stafi i agjencive jo-fitimprurëse do të kërkojnë të kenë role dhe përgjegjësi të përkufizuara

1 Ndonjëherë regjimi komunist në Shqipëri krahasohet me Korenë e Veriut të tanishme. <http://www.newyorker.com/news/sporting-scene/a-soccer-comeback-for-a-long-struggling-country>

2 Ende në proces publikimi

3 Ende në proces finalizimi

më qartë, si dhe aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur funksionin e tyre.

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri, si kudo, bashkojnë punonjësit social me personelin mjekësor, psikologjik dhe ata të zbatimit të ligjit. Megjithatë, punonjësit social profesionist janë të specializuar për të identifikuar dhe për t'ju përgjigjur shqetësimeve për mbrojtjen e fëmijëve sipas politikave, procedurave dhe standardeve të kujdesit, gjë që i bën ata të përbëjnë edhe thelbin për funksionimin e mirë të sistemit. Prandaj, punonjësit social duhet të kenë një përshkrim të qartë dhe kuptueshmëri të mirë të rolit të tyre, dhe më e rëndësishmja, të kenë aftësitë praktike për të përmbushur këtë rol.

Funksionet kryesore të këtij studimi janë pasqyrimi dhe kuptueshmëria e një panoramë të përgjithshme për praktikën e mbrojtjes së fëmijëve si dhe të aftësive, njohurive dhe interesat e stafit të shërbimeve

sociale, në mënyrë që ato të shërbejnë si themel për strategji dhe ndërhyrje që synojnë përmirësimin e mekanizmave dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Në mënyrë specifike, gjetjet e këtij studimi synojnë:

- Të ofrojnë një hartë të kontekstit të edukimit dhe trajnimit në të cilin ofrohen praktikat për mbrojtjen e fëmijëve (p.sh., sistemet ekzistuese për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, politikat dhe kuadrin ligjor përkatëse, edukimi për mbrojtjen e fëmijëve dhe menaxhimi i burimeve)
- Të identifikojë nevoja dhe mundësi për zhvillim, trajnim të mëtejshëm profesional dhe/ose ndërtim kapacitetesh për të fuqizuar stafin për mbrojtjen e fëmijëve në vend.

Në këtë drejtim, kapitujt e mëposhtëm të këtij raporti përfshijnë një identifikim të plotë të sistemeve të mbrojtjes sociale, shumëllojshmërinë profesionale dhe arsimore të forcës së punës që përfshihet për aktivitetet e mbrojtjes së fëmijëve dhe perspektivën e tyre për të ardhmen.

II. RISHIKIMI I LITERATURËS

Mbrojtja sociale në Shqipëri – një panoramë e përgjithshme

Krijimi i një sistemi të ri për mbrojtjen sociale në Shqipëri erdhi pas ndryshimeve drastike të rrëzimit të një prej diktaturave më të ashpra komuniste në botë. Themelet e sistemeve të reja për mbrojtjen sociale u parashikuan për herë të parë në Kushtetutën e Shqipërisë ku përfshiheshin dispozita kryesore si: “... drejtësia shoqërore dhe përkrahja shoqërore... janë baza e këtij shteti...” (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1991: Neni 2). Objektivat e parë strategjike të sistemit të ri për mbrojtjen sociale synonin që fillimisht të parandalonin degradimin e mëtejshëm të sigurisë sociale në vend (që erdhi si pasojë e ndryshimeve të menjëhershme socio-politike) dhe krijimin e një sistemi të ri dhe eficient të mbrojtjes sociale, i cili nuk do të adresonte vetëm problemet më emergjente, por do t’i rezistonte kohës dhe do t’i shërbente gjeneratave të ardhshme (Tomes, 1997).

Me një kuadër politik e ligjor më të konsoliduar (përfshirë kalimin e Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr. 7710, datë 18.5.1993, “Për asistencën dhe përkrahjen sociale”) u krijuan Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Personave të Persekutuar⁴ si dhe Administrata e Përgjithshme e Asistencës dhe Shërbimeve Sociale (GASAS)⁵ përgjegjëse për zbatimin e sistemit të përkrahjes sociale në vend. Shërbimi Social Shtetëror i krijuar në 1996 synonte të adresonte nevojat sociale duke mbuluar me aktivitetet e tij fushat e mëposhtme:

- *Ndihma ekonomike:* aktivizimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe pilotim i një programi për përfshirjen e familjeve në shërbimet në komunitet; pra, përdorimi i fondeve të programit të ndihmës ekonomike (NE) jo vetëm si skemë pasive vetëm me ndihë ekonomike për familjet në nevojë, por edhe për përfshirjen e kryefamiljarëve të familjeve në nevojë (pjesë e NE) në punë në komunitet;
- *Aftësitë e kufizuara:* ndjekja e dinamikës së skemës së pagesës me para (*cash*) për personat me aftësi të kufizuara, filtrimi i propozimeve nga njësitë vendore

dhe parashikimi i tyre për buxhetin e shtetit dhe dorëzimi këtij buxheti për aprovim në ministri;

- *Zgjerimi shërbimeve:* për shembull, u krijua dhe aprovua baza ligjore për shërbimet e përkohshme të kujdestarisë për fëmijët pa kujdes prindëror dhe filloi procesi i de-institucionalizimit në kuadër të reformës së shërbimeve sociale;
- *Standardizimi i shërbimeve sociale:* u aprovuan standardet për shërbime sociale themelore që ofrohen nga shteti për institucionet e kujdesit (PISC) për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, përkrah dispozitave sesi ato do të zbatoheshin;
- *Administrimi dhe buxhetimi* i shërbimeve sociale për kategoritë në nevojë;
- *Përmirësime institucionale:* një nga risitë ishte ngritja dhe funksionimi Drejtorisë së ShSSH për trajnime dhe projekte, qëllimi i të cilës ishte të standardizonte dhe të ofronte trajnim për strukturat që ofrojnë shërbime sociale.
- *Inspektimi të shërbimeve sociale:* funksioni i inspektimit të shërbimeve të kujdesit social të ShSSH, i cili u delegua në nivelin rajonal, ka qenë detyrë e ShSSH deri në 2012. Inspektorati kryente inspektime në përputhje me metodologjinë e inspektimeve të shërbimeve sociale që ofroheshin nga operatorë publik dhe privat, parashikuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.⁶
- *Licencimi i organizatave jo-fitimprurëse:* u krijua një strukturë e posaçme e ShSSH që identifikonte dhe licenconte OJQ-të që operonin në fushën e shërbimeve sociale. Për 11 vjet (1998-2009) marrëdhëniet shtet-shoqëri civile u bazuar fillimisht në një formë kontraktuale dhe më pas ShSSH realizoi procesin e plotë të licencimit.⁷

Këto organizime të reja, dhe sidomos lulëzimi i një sektori të ri, sektori i OJQ-ve, krijoi kërkesë për profesionistë që mund t’i përgjigjeshin këtyre detyrave dhe pozicioneve. Fakulteti i Punës Sociale në Universitetin e Tiranës (sot Fakulteti i Shkencave

4 Aktualisht Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)

5 Aktualisht Shërbimi Social Shtetëror (ShSSH)

6 Metodologjia është adoptuar me VKM Nr. 512, datë 31.05.2006.

7 Udhëzim 1321/10, datë 3.12.2003 “Për licensimin e personave fizik dhe juridik, përfshirë OJQ-të që ofrojnë shërbime të Kujdesit Social”

Sociale, që përfshin edhe departamentin e punës sociale) ka qenë shkolla e parë në vend që përgatiste punonjës socialë, e cila me krijimin e saj në 1992 i parapriu zhvillimeve të sipërpërmendura. Megjithatë, konsolidimi dhe integrimi i këtij profesion të ri në shoqërinë shqiptare do të kërkonte kohë.

Zhvillimet e mëvonshme dhe sidomos ato pas procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale filluar që në 2001⁸, sollën një sërë çështjesh dhe problemesh përfshirë paaftësinë e njësisve të qeverisjes vendore për të planifikuar fondet e për të bërë vlerësimin e nevojave në territorin e tyre, si dhe mungesën e një vizioni të qartë për lloje të reja shërbimesh apo për një filozofi të re që riformatonte qendra rezidenciale në qendra komunitare (Qendra Fëmijët Sot Tiranë, 2013). Në këtë kontekst, qeveria shqiptare me mbështetjen e UNICEF nisi në 2013 një reformë radikale për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe cilësinë e shërbimeve sociale për grupet vulnerabël, përfshirë fëmijët (SSS & UNICEF, 2014).

Reformimi dhe decentralizimi i shërbimeve, ende në proces, në sektorët kryesorë si shërbimet shëndetësore, qendrat e kujdesit ditor dhe pagesat e përkrahjes sociale, ofrojnë një mundësi shumë të mirë për ta planifikuar të ardhmen e shërbimeve sociale në Shqipëri në mënyrë të plotë dhe të integruar. Reformimi i ShSSH nga një institucion që fokusohet shumë tek ndihma në para (si *Ndihma Ekonomike*) në detyra të tjera, duhet të shoqërohet me ristrukturime të rëndësishme të burimeve njerëzore. Punonjësit social/administratorët social (rreth 500 administratorë social të punësuar në gjithë vendin për 2013) të cilët deri në atë moment fokusoheshin në administrimin e ndihmës ekonomike do të kalonin në një rol që fokusohet më shumë tek menaxhimi i rastit si pjesë e një qasjeje të përgjithshme e sistematike (Tahsini, Lopari, Lasku & Voko, 2013). Në valën e këtyre zhvillimeve të reja, në pjesët në vijim të këtij dokumenti analizohen mundësitë për edukim dhe edukim të vazhdueshëm të kësaj force pune.

Kuadri për mbrojtjen e fëmijëve

Që prej 1992, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

8 Filloi me kalimin e ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat shtetërore" ndryshuar me Ligj Nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave publike tek Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe miratimin e Ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për asistencën dhe shërbimet sociale".

Ratifikimi i saj u ndoq nga një numër dokumentesh të tjerë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë Protokollin Opsional mbi të Drejtat e Fëmijëve "Për procedurat e komunikimit" dhe Konventën e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me baza gjinore dhe dhunës në familje". Me ratifikimin e konventës së tretë opsionale mbi të drejtat e fëmijëve për "Procedurat e Komunikimit" Shqipëria është angazhuar të garantojë të drejtat e plota të fëmijëve në nivel ndërkombëtar, nëse nuk adresohen siç duhet në nivel lokal (MRSR, 2015).

Në vitin 2013, me vendimin Nr. 63 datë 26.11.2013, Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën "Për mbrojtjen dhe respektin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri". Angazhimet ndërkombëtare dhe ato vendase sollën disa ndryshime të rëndësishme të Kodit Penal shqiptar (miratuar me Ligjin nr. 144/2013, datë 20.5.2013) me synim përforcimin dhe garantimin e një mbrojtje të përshtatshme të fëmijëve nga krimet seksuale dhe abuzimi për përfitime ekonomike. Së fundmi, në vitin 2014 miratimi i Ligjit Nr. 155/2014 i hapi rrugë ngritjes së seksionit për të miturit pranë institucionit të Avokati Popullit në vend.

Megjithëse kuadri ligjor dhe rregullator duket se është rritur dhe konsoliduar mirë në dy dekadat e fundit të tranzicionit, rezultatet e arritura nëpërmjet zbatimit të tyre nuk kanë qenë shumë të kënaqshme, ndërsa një pjesë e rëndësishme e faktorëve shpjegues mendohet se lidhen me qasjen që është ndjekur për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve (Tahsini, Lopari, Lasku & Voko, 2013). Disa raporte monitorimi dhe vlerësimi kanë theksuar mungesën e një modeli apo qasjeje të mirë-përcaktuar për mbrojtjen e fëmijëve në vend (World Vision, 2013; BKTF, 2011; Save the Children, 2012) dhe nënvizojnë nevojën për të shkuar drejt një sistemi më gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve, që përfshin identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e gjithë rasteve, pavarësisht ndërlikimit të tyre (Voko & Tahsini, 2014).

Aktualisht po bëhen përpjekje për të pasur një qasje më të integruar, e cila ndër të tjera ka sjellë, krijimin e mekanizmave të rinj që ndahen në dy kategori kryesore: mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve dhe mekanizmat e referimit. Të dy synojnë të operojnë me një qasje të re të integruar të mbështetur tek parimet e bashkëpunimit multi-disiplinar dhe midis shumë agjencive, menaxhimin e rastit dhe ndërhyrjes në nivel vendor (MMSR, 2015). Ligji 10347 datë 4.11.2010

Tabela 2.1. Mekanizma për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri

NIVEL QENDROR	NIVEL VENDOR
<p>1. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve</p> <p>Misioni i tij është të koordinojë në nivel kombëtar, midis sektorëve me aktorët shtetëror dhe atyre privatë që respektohen të drejtat e fëmijëve në vend.</p>	<p>1. Njësia e të Drejtave të Fëmijëve (NJDF) në nivel qarku</p> <p>Në vend njihet si NJDF dhe është struktura e ngritur në nivel lokal për të koordinuar midis aktorëve vendor për zbatimin e praktikave për mbrojtjen e fëmijëve.</p>
<p>2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (koordinatori kombëtar për të drejtat e fëmijëve & çështjet e mbrojtjes)</p> <p>Është aktori kryesor i bërjes së politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve; harton dhe propozon tek këshilli i ministrave ndërhyrje të ndryshme politike.</p>	<p>2. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) në bashki (komunë)</p> <p>Këto njësi, që njihen në vend si NJMF, janë ngritur në nivel bashkie dhe funksionojnë brenda strukturës administrative të bashkisë si njësi të specializuara që merren me çështjet sociale. Kjo është njësi përgjegjëse për menaxhimin e fëmijëve në rrezik. Të paktën një prej punonjësve duhet të jetë punonjës social profesionist.</p>
<p>3. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve</p> <p>Institucioni kryesor i monitorimit roli kryesor i të cilit është të monitorojë zbatimin e kuadrit ligjor si dhe të koordinojë veprimet midis aktorëve të ndryshëm të zbatimit.</p>	

Burimi: Ligji 10347 datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve"

"Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" përkufizon mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor siç paraqitet më poshtë:

Sipas ligjit për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri, përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e fëmijëve në vend mbetet tek Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), e cila duhet të ngrihet në çdo njësi vendore. Që prej hapjes së NJMF-së së parë në 2006, ajo është bërë një strukturë kryesore e sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor. Megjithatë, kuadri ligjor parashikon gjithashtu që të gjithë aktorët dhe pjesëmarrësit të kenë detyrën statutores të mbrojnë fëmijët dhe në veçanti të mbështesin punën e NJMF-ve (Qendra, Fëmijët Sot, 2013). Edhe pse janë ngritur 12 NJDF për secilin qark dhe janë ngritur dhe funksionojnë 196 NJMF pranë njësive të qeverisjes vendore, vetëm 51% e vendit është e mbuluar (MMSR, 2015).

Aktualisht, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve po sfidohen në disa aspekte, ndër të cilat, mbase më e rëndësishmja lidhet me kapacitetet e burimeve

njerëzore për të ofruar shërbime sipas standardeve të kërkuara nga kjo qasje e re e integruar. Prandaj, ngrihet pyetja legjitime se kush po i mbron apo kush duhet t'i mbrojë fëmijët në Shqipëri?

Kush po i mbron fëmijët në Shqipëri? – Profesionist i Punës sociale

Shërbimi Social Shtetëror mbetet përgjegjës për stafin e institucioneve të shërbimeve të kujdesit social që ofrojnë shërbime në nivel kombëtar, gjë që nuk pritet të ndryshojë edhe pas përfundimit të reformës. E mbështetur nga buxheti i shtetit, agjencia ka rritur përpjekjet për të garantuar mbështetje më të gjerë edhe nga donatorët të ndryshëm⁹. Të dhënat e mësipërme për nivelin e mbulimit të ShSSH në gjithë vendin të lenë të kuptosh se pjesa tjetër ju është lënë OJQ-ve ta mbulojnë, ndërkohë që ato ofrojnë edhe mbështetje për shërbimet relativisht të dobëta atje ku ekzistojnë. Problemet e identifikuar gjatë një analizë

⁹ Për më shumë detaje mbi donatorët e ndryshëm dhe përfshirjen e tyre shikoni www.sherbimisocial.gov.al/donatore/.

Tabela 2.2. Përvoja profesionale e stafit të ShSSH

Positions	Profesionet						
	Eko-nomiks	Juridik/ marrëdhënie ndërkombëtare	Punë sociale/ psikologji/ filozofi	Mësues	Gjuhët e huaja	Mjekësi	Të tjera(bujqësi, shkencat e natyrës etj.)
Drejtor	53%	13%	7%	27%			
Inspektor	100%						
Shef sektori	50%	7%	14%	14%		7%	7%
Specialist	31%	18%	22%	10%	4%	5%	9%
Totali	53%	15%	18%	12%	3%	5%	8%

Burimi: ShSSH siç është paraqitur tek Analiza Institucionale e Shërbimit Social Shtetëror për rolet, përgjegjësitë dhe detyrat në kuadër të Reformës së Shërbimit të përkrahjes sociale, Qendra Fëmijët Sot, qershor 2013

mbi aktivitetin dhe kapacitetet e Shërbimit Social Shtetëror në katër vitet e fundit, mund të ndahen në dy kategori kryesore: a. Mospërputhshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës me pozicionin/përshkrimin e punës dhe b. Paqëndrueshmëri dhe përvojë pune e kufizuar për shkak ritmeve të larta të ndryshimeve në staf (Qendra Fëmijët Sot, 2013).

Në Shqipëri, administrata publike në tërësi është karakterizuar nga ndryshime të shpeshta dhe paqëndrueshmëri të burimeve njerëzore (Dhembo, 2014). Të dhëna nga ShSSH (Qendra Fëmijët Sot, 2013) tregojnë se vetëm për një periudhë 4 vjeçare (2009-2013), për shkak të ristrukturimeve të vazhdueshme dhe ndryshimit të personelit që bëhet nga drejtorët e rinj të sapoemëruar, u pushuan 150 specialistë në institucionet qendrore¹⁰ dhe ato të varësisë. Rekrutimi i stafit të ShSSH rregullohet nga ligji për shërbimet sociale, me akte nënligjore përkatëse, si dhe nga Kodi i Punës që mbetet dokumenti kryesor ligjor. Duke qenë se kjo bazë ligjore i jep shumë liri procesit të rekrutimit, vazhdimësisë apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, bën që qëndrueshmëria e burimeve njerëzore, ecurisë në karrierë dhe profesionalizmi i tyre të ndikohen ndjeshëm¹¹.

Për pasojë jo vetëm gjysma e stafit rezultonte pa ndonjë eksperiencë të mëparshme në ShSSH¹², por ka edhe

probleme për shkak të mospërputhjes së ekspertizës profesionale me pozicionin e punës dhe (kur ekziston) me përshkrimin e punës. Tabela 2.2 tregon se për çdo pozicion (drejtor, shef sektori dhe specialist) ka një shumëllojshmëri profesionesh. Megjithatë, që prej 1990 me qindra të diplomuar për punë sociale janë në tregun e punës, ata vazhdojnë të mbeten, edhe pas 15 vitesh, një pakicë për shkak të problemeve të procedurave të rekrutimit, por dhe për shkak të një pozicioni ende të brishtë të profesionit të punës sociale krahasuar me profesionet e tjera në vend.

Për shkak të politikave dhe procedurave problematike për punësimin e stafit të ShSSH ndër vite, është vënë seriozisht në rrezik ekuilibri kërkesë-ofertë midis shkencave sociale dhe sidomos për profesionistët e arsimuar në punë sociale dhe vendeve të punës në dispozicion. Nga ana tjetër, grupi i madh i paraprofesionistëve ose “punonjësit e vijës së parë” që nuk përputhen me kriteret arsimore strikte, parashikuar për punonjësit profesionist të punës sociale, duhet të kenë vëmendje të veçantë gjatë reformës së re të shërbimeve sociale. Ata duhet të përshtaten me ndryshimet e reja që do të pasojnë Urdhrin e Punonjësve Social dhe duhet të kuptojnë rolin, kompetencat dhe detyrat brenda sistemit. Ata duhet të trajnohen për të fituar aftësitë specifike që nevojiten për të përmbushur atë rol (Tahsini, Lopari, Lasku, & Voko, 2013).

10 SSS Administrata, inspektorët e zyrave rajonale dhe stafi I SCI

11 Analiza institucionale e Shërbimit Social Shtetëror, rolet, detyrat dhe përgjegjësitë në kuadër të Reformës së shërbimeve sociale, Qendra Fëmijët Sot, Qershor 2013

12 Shikoje për detaje Tabelën 4 të Analizës Institucionale të Shërbimit Social Shtetëror, rolet, detyrat dhe përgjegjësitë në kuadër të Reformës së shërbimeve sociale, Qendra Fëmijët Sot, Qershor 2013

Në përgjigje të kësaj situate, me mbështetjen e UNICEF-it dhe angazhimit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinise, si dhe të Departamentit të Punës Sociale dhe Politikave Sociale, Universiteti Tiranës, u harrua një ligj i ri që më pas u miratua në parlament në 2014 mbi "Urdhrin e Punonjësve Social në Republikën e Shqipërisë" me synim që të rregullojë profesionin e punës sociale në vend. Përfshirja e punës sociale tek lista e profesioneve të rregulluara është me rëndësi të veçantë jo vetëm për profilizimin e profesionistëve që mbulojnë fushën e punës sociale, por edhe për rritjen e fushave dhe profileve ku ka fituar terren puna sociale; si shërbimet e përkrahjes për grupet vulnerabël, gratë, fëmijët, shërbimet e shëndetit mendor, shërbimet për fëmijët dhe familjet, shërbimi i provës, shërbimi psiko-social në shkollë, fusha e shëndetit riprodhues, etj. (Tahsini, Lopari, Lasku, & Voko, 2013). Ky ligj vjen në një kohë kur punonjësve social ju është dhënë një rol kryesor me reformën e re dhe me qasjen e integruara të shërbimeve sociale në vend, ku ngarkohen me përgjegjësinë e integritetit të modelit të menaxhimit të rastit të punës sociale tek shërbimet sociale (Tahsini, Lopari, Lasku, & Voko, 2013:5). Pritshmëritë e përgjithshme janë që të ketë një ndikim pozitiv për të rregulluar profesionin, të fuqizojnë këtë profil dhe të garantojnë më shumë efikasitet dhe profesionalizëm në ofrimin e shërbimeve sociale në vend.

Arsimimi për punën sociale në Shqipëri

Një panoramë e arsimimit në punë sociale

Në Shqipëri, burimi kryesor nga vijnë të diplomuarit në punë sociale janë tri shkollat e punës sociale të vendosura në tri universitete shtetërore në vend: Universiteti i Tiranës, në kryeqytetin e Shqipërisë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Në fillim të viteve 1990, puna sociale ishte një profesion fare i ri për publikun, për sistemin arsimor dhe për tregun e punës në Shqipëri. Në ato vite Shqipërisë nuk i mungonte vetëm historia e profesionit të punës sociale, por edhe trashëgonte nga e shkuara një traditë të varfër bamirësie deri në 1945 për shkak të një sërë faktorësh shoqërorë, ekonomikë dhe historikë (shiko Hoxha, 2011) dhe nga dominimi absolut i ideologjisë socialiste për më shumë se 50 vite (1945 – 1990) ku strukturat e partisë rregullonin problemet/sjelljet shoqërore dhe ku puna "vullnetare" në fakt ishte me detyrim¹³.

Në vitin 1992, Universiteti i Grand Valley, Miçigan dhe Shërbimet Sociale Bethani në Shqipëri mbështetën nismën e një grupi intelektualësh dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (sot MMSR) për fillimin e shkollës së parë të punës sociale, atëherë Fakulteti i Punës Sociale, Universiteti i Tiranës. Që nga 1992 deri 1995, tri kurse 1-vjeçare për punë sociale krijuan kapacitetet e para lokale, ndërsa studentët e parë me diplomë universitare katër-vjeçare u diplomuan në 1996.

Nuk ka statistika për të raportuar numrin e personave të diplomuar në vend nga të gjitha shkollat e punës sociale dhe/ose për ata që kthehen nga jashtë dhe kanë studiuar punë sociale (nëse ka të tillë)¹⁴. Megjithatë, janë më shumë se 1500 punonjës social që kanë ndjekur studimet me kohë të plotë dhe janë diplomuar në më shumë se 20 vjet vetëm nga Universiteti i Tiranës. Megjithëse, mungojnë hulumtime të plotë, hulumtimet e pjesshme tregojnë se OJQ-të/ sektori jo-fitimprurës mbetet punëdhënësi më i madh, pjesa tjetër e të diplomuarve për punë sociale punojnë si në institucione private edhe publike, në pozicione që lidhen me punën njerëziteti, si, marrëdhënie me publikun, burime njerëzore, shërbime për klientin, etj. (Hoxha et al, 2012).

Kurrikula e Punës Sociale

Programi i parë i diplomave katër-vjeçare (*bachelor*) në Shqipëri filloi në 1992 dhe solli në vend një nga kurrikulat më të avancuara për kohën, atë të shkollës amerikane të punës sociale me ndihmën e Universitetit të Grand Valley në Sh.B.A. Kjo i dha një pozicion fillestar të favorshëm punës sociale në Shqipëri, krahasuar me shkollat e tjera në rajon, ku puna sociale ishte ende diplomë kolegji, si në Greqi dhe Itali.

Dy programe të tjera ndoqën Universitetin e Tiranës, ai i Shkodrës (në 2005) dhe ai i Elbasanit (në 2004). Programet e tyre u zhvilluan ndër vite dhe janë akredituar nga Agjencia Publike për Akreditimin e Arsimit të Lartë në vend (<http://www.aal.edu.al/sq/>). Krahas programeve *bachelor* me kohë të plotë, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti "Aleksandër

14 Megjithëse të dhënat mund të mblidhen duke kontaktuar autoritetet përgjegjëse një nga një, publikisht nuk ka të dhëna të grumbulluara apo në dispozicion për publikun. Urdhri i Punonjësve Social pritet që të kontribuojë tek krijimi i një baze të dhënash për të gjithë të diplomuarit e punës sociale që do të aplikojnë për licencim.

13 Gjatë komunizmit, të gjithë ishin të detyruar të përfshiheshin në "punë vullnetare" për të kontribuar për ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Tabela 2.3.

Shkollat e Punës Sociale	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani"
PROGRAMET UNIVERSITARE (BACHELOR)			
Programet bachelor me kohë të plotë (3 vjet)			
Ba. Për Punë Sociale	x	x	x
Ba. Për Administrim Social	x		
Programet bachelor me kohë të pjesshme (5 vjet)			
Ba. Për punë sociale	x		x
PROGRAMET MASTER			
Programet Master i Shkencave (2 vjet)			
MSc. Punë Sociale	x		
MSc. Komunikim për ndryshimin social dhe të sjelljes	x		
MSc. Administrim social	x		
MSc. Punë Sociale me fëmijët dhe familjet	x		
MSc. Përkatësi Gjinore dhe Zhvillimin	x		
MSc. Shërbime Sociale dhe Drejtësi Penale	x		
MSc. Shërbime Sociale			x
Programet Master Profesional (1 vit)			
Ma. Analist i Politikave Sociale	x		
Ma. Punë Sociale	x		
Ma. Punë Sociale me fëmijët dhe familjet			x
Ma. Shërbime Sociale në Drejtësinë Penale			x
Kurse të akredituara ose proces akreditimi			
Kursi "çështje të mbrojtjes së fëmijëve"	x		
Programet doktoraturë			
Doktor i shkencave në punë sociale (3-5 vjet)	x		

Xhuvani" në Elbasan ofrojnë edhe programe *bachelor* me kohë të pjesshme, të cilat zgjasin më shumë se tre vjet. Ndryshe nga disiplinat e tjera, puna sociale nuk ka rezultuar tërheqëse për sektorin e arsimit privat që ka lulëzuar në vitet e fundit; ndërsa disiplina të tjera të shkencave sociale si shkencat politike, psikologjia dhe sociologjia kanë pasur programe të reja të zhvilluara në sektorin privat, puna sociale nuk ka hasur ndonjë zhvillim të tillë. Kjo mungesë e interesit për punën sociale nga universitetet private mund të jetë rezultat i kombinimit të një hapësire të kufizuar për punonjësit socialë në tregun e punës si dhe të një niveli të ulët informimi dhe ndërgjegjësimi për këtë profesion në publikun e gjerë.

Pas më shumë se një dekade studentësh të diplomuar në punë sociale, kursi fillestar katër vjeçar u prek shumë nga reformat e nevojshme të programit sipas

Procesit të Bolonjës. Që prej 2005, shkollat e punës sociale në vend përputhën programet e tyre me Kartën e Bolonjës për standardet e arsimit të lartë për Evropën dhe prandaj programi i punës sociale në vend kaloi nga një sistem 4+1 tek një sistem 3 (universitar) +2 (pas-universitar). Në kuadër të këtyre zhvillimeve dhe sfidave e mundësive të reja, me mbështetjen e UNESCOs, Departamenti i Punës Sociale në Tiranë udhëhoqi një program një vjeçar (në bashkëpunim me dy shkollat e tjera të punës sociale në Elbasan dhe Shkodër) për krahasimin dhe akordimin e kurrikulës së punës sociale në nivelin qendror (Departamentin e Punës Sociale, UT, 2009).

Gjatë një analize krahasuese të kurrikulës së tri shkollave të punës sociale, doli se të dyja kurrikulat, ajo e Universitetit të Shkodrës dhe të Elbasanit, mbështeteshin shumë tek kurrikula e shkollës

së parë sociale, ajo e Universitetit të Tiranës, që ndiqte kryesisht një teori ekologjike dhe një qasje gjeneraliste. Megjithatë, u gjetën disa mangësi të rëndësishme tek të dyja programet që vinin kryesisht nga kufizimet në burime njerëzore (për shembull, një nga kurset themelore për arsimimin në punë sociale është Sjellja Njerëzore dhe Mjedisi Social, i cili nuk ishte konsoliduar në asnjërën prej të dy shkollave të tjera) (Tahsini, Duci, & Ajdini, 2009).

Qysh atëherë, kurrikula e tri shkollave të punës sociale në vend duhet të jenë përafuar edhe më shumë si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë midis shkollave, kualifikimeve të mëtejshme të stafit lokal, si dhe përpjekjeve të përbashkëta të stafit akademik të tri shkollave për të përgatitur literaturën në gjuhën lokale. Përmirësimi i programeve të punës sociale në vend ka synuar ndër të tjera, të pasqyrojë zhvillimit lokale në nivel politikash, të kuadrit ligjor, punësueshmërisë së punonjësve socialë në Shqipëri. Me interes të veçantë ka qenë zgjerimi i teorisë dhe praktikës së punës sociale në ato fusha ku politikë-bërësit kanë rritur kërkesën për punonjës social si, për shëndetin mendor (me krijimin e ekipeve multi-disiplinare që janë parashikuar nga ligjet për shëndetin mendor në 1996 dhe 2012), mbrojtjen e fëmijëve (ligji që kaloi në 2010 për mbrojtjen e fëmijëve parashikon qartë se stafi i NJMF-së duhet të jetë i diplomuar për punë sociale), edukimin (ligji i 2012 për shërbime psiko-sociale në shkolla) dhe mirëqenien e fëmijës (me ngritjen e institucioneve rezidenciale për kujdesin e fëmijëve dhe strehëzat rezidenciale për gratë e abuzuara dhe viktimat e trafikimit). Megjithatë, kjo kërkesë për profesionistë të trajnuar nuk shfaqet siç pritet në realitet për shkak të problemeve të punësimit që u përmendën më sipër në këtë dokument.

Pavarësisht raportit jofunksional kërkesë-ofertë, programet universitare për punë sociale vazhdojnë të ndjekin një qasje gjeneraliste për përgatitjen dhe diplomimin e studentëve të punës sociale që janë:

1. Profesionistë që kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të praktikuar punë sociale me individin, grupet dhe komunitetet.
2. Kërkues që mund të kryejnë hulumtime në praktikën e tyre dhe të kontribuojnë tek zhvillimi i teorisë dhe evidencave;

3. Udhëheqës dhe advokues të mbrojtjes sociale në vend.

Qasja gjeneraliste është përshtatur si mënyra më e mirë për kontekstin shqiptar për shkak të tregut të papërkufizuar të punës për punonjës social dhe sidomos duke pasur parasysh mundësinë për t'u specializuar më shumë tek studimet pas-universitare. Aktualisht, Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale, Universiteti i Tiranës (institucioni kryesor i studimeve pas-universitare për punë sociale në vend, përfshirë studimet doktorale) ofron një shumëllojshmëri prej 5 studimesh për Master Shkencor dhe dy Mastera Profesionalë (Ma.) që variojnë nga puna sociale e avancuar tek puna sociale në sistemin e drejtësisë dhe komunikimi për ndryshimin e sjelljes. Logjika pas programit gjeneralist të punës sociale është ajo e një qasje holistike/gjithëpërfshirëse, gjë që është në linjë edhe me qasjen e re që ka përqafuar Shërbimi Social Shtetëror.

Programet master, nga ana tjetër, ndjekin mënyrën sesi shpalos ofertat tregu i punës për punonjës socialë në Shqipëri dhe përpiqen t'i përgjigjen nevojave me specialitete të caktuara. Si rezultat, kurrikula e tyre përshtatet për të ndihmuar profesionistët e punës sociale për profile të ndryshme pune që lidhen me praktikën e punës sociale me individë, grupe dhe komunitete.

Studimet Doktorale ofrohen vetëm nga shkolla e punës sociale në Universitetin e Tiranës. Programi merr studentë nga Shqipëria dhe rajoni, kryesisht nga Kosova dhe Maqedonia. Ndër të diplomuarit e parë kanë qenë edhe anëtarë të stafeve të tri shkollave të punës sociale në Shqipëri.

Kërkimi

Kërkimi është një komponent kryesor tek programet e punës sociale në Shqipëri. Megjithatë, dallimet mund të vihen re midis Universitetit të Tiranës dhe dy shkollave të tjera në vend. Tek programi *bachelor* për punë sociale i Universitetit të Tiranës, metodat kërkimore jepen në vitin e parë dhe të dytë, në tre semestra që përfshijnë lëndët Hyrjen në Statistika, Metodën Kërkimore Sasiore, dhe Metoda Kërkimore Cilësore. Vetëm 1/3 e kësaj peshe specifike i jepet kërkimit shkencor tek dy shkollat e tjera nëpërmjet kursit Hyrje në Metoda Kërkimore.

Krahas studimit të metodave kërkimore, studentët familjarizohen gjatë studimeve të tyre me rëndësinë e rezultateve të kërkimeve, evidencave dhe rëndësisë që kanë ato në vlerësimin e programeve, advokaci, në bërjen e politikave sociale, etj. Megjithatë, Dauti dhe Bejko (2015), gjatë adresimit të çështjes së politikë=bërjes së mbështetur në evidenca, zbuluan se një përjasje e përgjithshme studimore e mbështetur në evidenca mungon edhe në programet universitare të punës sociale. Kërkimet dhe evidencat lokale janë të kufizuara, gjë që çon në një numër të vogël studimesh të bazuara në meta-analizë ndaj fokusi kryesor i programit është të mësojë studentët të bëhen kërkues për studime të bazuara në të dhëna parësore (f. 22-23). Një fokus më i madh tek politikë=bërja e mbështetur në evidenca dhe tek vlerësimi i programeve sociale vihet në programet më të avancuara të studimit si në Master Shkencor dhe studimet e doktorale.

Megjithatë, sfida më e madhe për studentët e punës sociale dhe praktikantët e ardhshëm mbetet krijimi i aftësive praktike për kërkimet. Detyrat e kursit janë mënyra kryesore për t'i përfshirë tek praktika kërkimore. Pavarësisht kësaj, mungesa e infrastrukturës dhe burimeve për punë në laborator dhe në terren si dhe aksesit tepër i kufizuar për burimet dytësore të të dhënave bën që studentët e punës sociale t'i drejtohen diplomimit me një ekuilibër të pabarabartë midis teorisë dhe praktikës së kërkimit shkencor në punë sociale. Ky problem është veçanërisht serioz për studimet me kohë të pjesshme në vend, ku praktika është edhe më e kufizuar pasi edhe puna në klasë e tyre është edhe më e reduktuar.

Në këtë kontekst, nuk do të ishte realiste të pretendohet se punonjësit socialë profesionistë (e jo ata para-profesional dhe në nivel komuniteti) të jenë të pajisur me të gjitha njohuritë bazë të metodave kërkimore për të bërë vetë kërkime dhe/ose vlerësime për çështjet dhe programet e mbrojtjes së fëmijëve. Kjo është një nga fushat ku duhet të ndërtohen apo të fuqizohen kapacitete në një linjë me reformën e shërbimeve sociale në vend.

Politikat

Mirëqenia e fëmijës, mbrojtja e fëmijëve dhe puna sociale me fëmijët janë fushat kryesore që mbulojnë programet e punës sociale në vend. Legjislacioni për

mbrojtjen e fëmijëve (përfshirë kuadrin ndërkombëtar dhe kombëtar) dhe çështjet për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve janë pjesë integrale e disa prej kurseve të programit që përfshijnë: punën sociale me fëmijët, punën sociale në sistemin ligjor, etikën e punës sociale, problemet sociale, politikat sociale, etj. Studentët e punës sociale nuk mësojnë vetëm për të drejtat e fëmijëve dhe problemet në mbrojtjen e fëmijëve, por edhe si të përfshihen dhe të ndikojnë tek këto çështje në vend nëpërmjet advokacisë dhe angazhimit tek proceset e bërjes së politikave. Si të tilla, advokacia, politikat sociale dhe puna në komunitet janë pjesë integrale e programit në përgjithësi dhe në kurse specifike në veçanti. Megjithatë, nuk janë bërë vlerësime për të analizuar gatishmërinë e të diplomuarve në punë sociale dhe efektivitetin e profesionistëve të punës sociale (përfshirë paraprofesionalët dhe/ose punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në nivel komuniteti) për angazhimin dhe influencimin e politikave që lidhen me fëmijët në vend.

Praktika

Arsimi për punën sociale në Shqipëri filloi shumë mirë përse i përket integritit të praktikave në kurrikulë. Për më shumë se një dekadë tek programi i kursit katër-vjeçar *bachelor*, kurrikula e punës sociale përfshinte që në vitin e dytë praktikën për studentët e punës sociale, që sa vinin e shtoheshin gjatë programit, derisa arrinin të zëvendësonin një semestër të plotë me praktikë tek institucionet ose organizatat e shërbimit social/kujdesit social në vend. Me kalimin tek modeli 3+2 sipas programit të Bolonjës, praktika ishte komponenti që u prek më shumë nga programi *bachelor*. Komponenti i praktikës u reduktua nga shpërndarja në tre vjet e programit katër-vjeçar që kulmonte me një semestër të plotë praktike në vitin e katërt, në një total prej 160 orësh gjatë programit tre vjeçar. Ky reduktim drastik i praktikës e largoi shkollën tonë nga modelet arsimore më të zhvilluara në botë (p.sh. shkollat për punë sociale në M.B, Sh.B.A dhe vendet nordike) ku praktika ze të paktën 1/3 e programit të punës sociale.

Praktika e pakët është edhe një nga sfidat kryesore për kultivimin e aftësive të të diplomuarve të punës sociale. Megjithatë, edhe me mundësitë ekzistuese ka probleme përse i takon procesit të vendosjes në një vend praktike, monitorimit dhe vlerësimit të praktikës së studentëve të punës sociale. Stazhi i praktikës

është dokumentuar si një nga elementët kryesor dhe jo vetëm për të fituar aftësi të reja dhe eksperiencë, por edhe për të shërbyer si urë lidhëse midis institucioneve akademike dhe studentëve të punës sociale nga një anë, dhe mundësive për punësim në sektorin publik dhe privat nga ana tjetër (Haxhiymeri & Dhembo, 2010). Në këtë kontekst, Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës sociale në Universitetin e Tiranës, me mbështetjen e MMRS dhe UNICEF Shqipëri synojnë të angazhohen për të përgatitur një kurrikulë të re në përputhje me kërkesat e reja që lindin nga reformimi i ShSSH, me një fokus të veçantë tek përmirësimi komponentit të praktikës. Meqë Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale në Universitetin e Tiranës është bërë pjesë vitet e fundit në shoqatat e shkollave ndërkombëtare të punës sociale (si Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave për Punë Sociale – ShNSHPS dhe Shoqata Evropiane e Shkollave për Punë Sociale – SESPS) standardet ndërkombëtare do të reflektohen përgjatë përshtatjes së programit edhe me tendencat dhe zhvillimet ndërkombëtare.

Edukimi i vazhdueshëm edhe ngritja e kapaciteteve për stafin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve

Ligji për "Urdhrin e punonjësve sociale në Republikën e Shqipëri" ndër të tjera përfshin edhe kuadrin bazë për edukimin e vazhdueshëm në vend (i cili do të ndiqet nga aktet përkatëse nënligjore). Megjithatë, deri tani, edukimi në vazhdim për punë sociale në vend ka qenë sporadik, i pastrukturuar dhe rrallëherë është inventarizuar dhe vlerësuar. Kreditet për aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve i atribuohen mbështetjes së organizmave të ndryshme ndërkombëtare si UNICEF, TdH, Save the Children, World Vision etc. dhe të vetmes shoqatë lokale për punën sociale në vend, Shoqata Kombëtare për Punonjësit Social në Shqipëri.

Me fokus të veçantë tek të drejtat dhe mbrojtja e fëmijëve, Agjencia Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm është përfshirë në fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzor në nivel lokal për problemet e mbrojtjes së fëmijëve. Përpyekjet e tyre janë shtrirë edhe tek profesionistë të tjerë si policia, gjykatësit, stafi OJQ-ve, etj., të cilët janë përfshirë në rrjetin për e aktorëve për mbrojtjen e fëmijëve

sipas një qasjeje shumë-sektoriale. Sipas të dhënave zyrtare të MMSRS, vetëm për periudhën 2013-2014, janë trajnuar në total 250 profesionistë (MMSRS, 2015).

Spektori i OJQ-ve ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë viteve për ngritjen e kapaciteteve të stafit për mbrojtjen e fëmijëve. Kontributi më i rëndësishëm është realizimi për herë të parë i një kursi të formalizuar dhe në proces akreditimi mbi çështjet për mbrojtjen e fëmijëve me titull "programi i trajnimit në detyrë". Ky rezultat i bashkëpunimit të frytshëm midis MMSR, Departamentit të Punës Sociale, Universitetit të Tiranës dhe një numër OJQ të udhëhequra nga Tdh Shqipëri, kishte si objektivë kryesore t'i ofronte Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Profesionistëve për Mirëqenien e Fëmijëve një paketë aftësish bazë dhe njohuri themelore për të garantuar standardet minimale të shërbimit për mbrojtjen e fëmijëve. Kursi u zbatua për herë të parë në vitin akademik 2014-2015 për 30 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve nga i gjithë vendi (MMSR, 2015).

Kursi për mbrojtjen e fëmijëve është vetëm hapi i parë i rrugës së gjatë për ndërtimin dhe konsolidimin e edukimit në vazhdim në punë sociale në përgjithësi dhe për mbrojtjen e fëmijëve në veçanti. Zhvillimet në nivel politikash, përfshirë reformën e shërbimeve sociale dhe rregullimin e profesionit të punës sociale janë një *momentum* që duhet shfrytëzuar sa më mirë në këtë aspekt.

Ky rishikim i literaturës ofroi një kuadër gjithëpërfshirës të panoramës të shërbimeve sociale shqiptare dhe të kuadrit arsimor të forcës së punës të shërbimit social; megjithatë, ai nuk na ndihmon shumë të mësojmë sesi funksionimi, cilësia dhe sasia e shërbimeve sociale shpalosen në praktikë. Kjo mangësi në literaturë, synohet të mbushet nga të dhënat që do dalin nga kërkimi në terren dhe analiza e tyre që do të prezantohet në seksionet e mëposhtme të këtij raport.

III. METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij studimi është të kuptojë dhe ofrojë një panoramë të përgjithshme të praktikave të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri si dhe të aftësive, njohurive dhe interesave të përforcës së punës së shërbimit social, në raport me çështjet e mbrojtjes së fëmijës për të shërbyer si themeli për strategjitë dhe ndërhyrjen me synim përmirësimin e mekanizmave të përgjithshëm të mbrojtjes së fëmijëve në vend. Më specifikisht, gjetjet e studimit synojnë:

- Të pasqyrojnë kontekstin arsimor dhe të trajtimeve në të cilat ofrohen praktikat për mbrojtjen e fëmijëve (p.sh., sistemet ekzistuese për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, kuadri politik që lidhen me të, edukimi për mbrojtjen e fëmijëve, dhe menaxhimi i burimeve);
- Të identifikojnë nevojat dhe mundësitë për zhvillime të mëtejshme profesionale, trajnime dhe/ose ngritje kapacitetesh për të fuqizuar forcën punëtore për mbrojtjen e fëmijëve në vend.

Në kuadër të këtyre çështjeve, analiza e zgjeruar e literaturës shoqërohet nga të dhënat parësore të mbledhura përmes metodave kërkimore cilësore duke garantuar një kuptim më të thellë të sistemit se si ai funksionon në praktikë dhe të mundësive dhe nevojave për zhvillime të mëtejshme, sipas aktorëve përkatës të përfshirë në studim nëpërmjet një strategjie kampionimi të variacionit maksimal.

Rishikimi i literaturës – u mbledhën dhe u shqyrtuan gjithë dokumentet e aksesueshëm e relevantë për tematikën që ndër vite janë prodhuara nga organet qeveritare, jo-qeveritare dhe akademike në vend me qëllim një hartëzim paraprak të situatës, por edhe zhvillimin e komponentit cilësor të studimit. Konsultimet me informatorët kyç në fushën e studimit ndihmuan për identifikimin e burimeve.

Kërkimi në terren – Puna në terren u krye nga qershori deri në shtator 2015. Fillimisht, ishte planifikuar vetëm për një periudhë më të shkurtër, por puna u zgjat për shkak të situatës me zgjedhjet vendore në vend (qershor 2015) dhe pushimeve verore të institucioneve akademike (mes korriku – gushti 2015).

Për të garantuar thellësi dhe gjerësi në eksplorimin e të gjitha perspektivave gjatë eksplorimit të kësaj teme, u përdor një kombinim i teknikave të mbledhjes së të dhënave cilësore. Intervistat gjysmë të strukturuar, studimet e rastit dhe fokus-grupet me në brendësi një ushtrim për arritjen e konsensusit u aplikuan në tri kategori kryesore përgjigjedhënesish: a. Praktikantët (përfshi studentët), b. edukatorët, dhe c. menaxherët. Kampioni, edhe pse jo-probabilistik dhe përfaqësues për të gjithë forcën e punës në shërbimet sociale shqiptare, përfshiu në total 62 persona nga tri rajonet kryesore të vendit; ai qendror (Tirana), verior (Shkodra) dhe jugor (Vlora dhe Fieri)¹⁵. Krahas kësaj, u zbatuan edhe kriteret e përzgjedhjes për të garantuar një variacion maksimal pjesëmarrësish në studim dhe të informacionit për analizë.

Tabela 3.1 jep në mënyrë të përmbledhur matricën për mbledhjen e të dhënave, kategoritë dhe numrin e personave, kriteret e përzgjedhjes, zonat gjeografike që u mbuluan, kohën dhe burimet njerëzore të përfshira gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave.

Analizimi i të dhënave – të gjitha të dhënat e grumbulluar gjatë intervistave gjysmë të strukturuar, diskutimeve në fokus-grupe dhe historive të rasteve u transkriptuan dhe u përgatitën për analizën duke shënimit nga terreni dhe materialet audio të regjistruara. Së fundmi, këto të dhëna u analizuan nga ana tematike dhe u përdorën për të kuptuar më shumë sistemin për mbrojtjen e fëmijëve, proceset, profesionalizmin, sfidat dhe interesat. U përdorën dy nivele kodimi. I pari u krye duke përdorur fjalët kyçe që dolën nga temat me interes:

- Panorama e punonjësve të shërbimit social
- Edukimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore
- Aftësitë, njohuritë dhe interesat

Gjatë fazës së dytë, analiza u fokusua tek eksplorimi i dallimeve dhe të përbashkëtave midis kategorive të ndryshme të përgjigjedhënesve si p.sh, diferencat midis pjesëmarrësve profesionistë të punës sociale dhe atyre jo- profesionistë pjesë e shërbimeve

¹⁵ Shënim: studentët vijnë nga zona të ndryshme.

Tabela 3.1. Matrica e strategjisë së kampionimit

Mjeti	Kategoria e të intervistuarve	Kriteret kryesore të përzgjedhjes	Nr. i njësive të kryera	Nr. Pjesëmarrësve për njësi	Mbulimi gjeografik	Afati kohor	Burimet njerëzore
Intervistë gjysmë e strukturuar (IGJS)	Edukator	Të paktën një IGJS për shkollë të punës sociale në vend	4	1	<ul style="list-style-type: none"> Universiteti i Tiranës(2 intervista; një jepte mësim edhe tek Universiteti i Elbasanit) Universiteti Luigj Girakuqi (Shkoder; 2) 	Qer. (2); Shtat. (2)	Kërkuesi
	Praktikantët	Përfaqësimi i përvoja në praktikë nga Tirana (kryeqyteti); një zonë tjetër urbane; dhe një me përvojë për zonat rurale dhe të largëta	4	1	<ul style="list-style-type: none"> Tirana (1) Vlora (2) (Shënim: një nga të intervistuarit në Vlorë i referohet përvojës së saj me zonat rurale). Fier (1) 	Maj - Qershor	Kërkuesi
	Menaxherë	Të paktën një për çdo nivel menaxherial (qev. qendrore.; NjDNj; OJQ/NJMF)	3	1	<ul style="list-style-type: none"> Tirana Vlora Tirana 	Qershor	Kërkuesi
	IGJS Total			11			
Histori rasti (HR)	Praktikantë	Të paktën një për secilën kategori: <ul style="list-style-type: none"> Punonjës social profesional Me arsimim tjetër Punonjës MF OJQ 	4	1	<ul style="list-style-type: none"> NJMF (Tirana) JMF(Vlora) OJQ (Tirana) 	Qershor	Kërkuesi
	HR në total			4			
Fokus-grup dhe Ushtrimi i konsensusit (FG)	Edu. & menaxherë	Edukatorë (Universitete dhe OJQ)	1	6	Tirana	Qershor	Kërkuesi dhe personi që mbante shënimet
		Grupe multidisiplinare	1	5	Tirana		
	Praktikantët	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve	1	5	Tirana	Maj	Kërkuesi dhe personi që mbante shënimet
		OJQ dhe Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve	1	8	Elbasan		
	Studentë	Niveli Bachelor	1	8	Tirana	Qershor	Kërkuesi dhe personi që mbante shënimet
Niveli Master		1	7	Tirana			
Master Profesional, por me studime bachelor në Shkodër dhe Elbasan		1	8	Shkodra			
	FG Totali			47			

sociale, diferencat arsimore dhe gjeografike, ato midis aktorëve shtetëror dhe jo-shtetërorë, etj.

Etika -Elementet e etikës së kërkimit u adresuan gjatë gjithë procesit të studimit. U bënë konsultime të rregullta midis kërkuesit dhe menaxherit lokal të platformës Tdh Hub në Tiranë. Çdo pjesëmarrës i mundshëm u kontaktua më parë me telefon ose me e-mail dhe u informua për studimin që po kryhej

dhe rolin e tij/saj në të. Krahas kësaj, në fillim të çdo interviste, diskutimi në fokus-grup ose intervistimit për histori rasti, pjesëmarrësit u informuan me hollësi dhe ju kërkua pëlqimi për të marrë pjesë vullnetarisht në kërkim. Një kopje e letrës së miratimit gjendet tek shtojcat e këtij raporti. Ndër të tjera, pjesëmarrësve ju premtua konfidencialiteti, prandaj detajet që mund të tregojnë identitetin e pjesëmarrësve nuk janë përfshirë në raport.

IV. REZULTATET

Ky seksion përmban gjetjet nga analiza cilësore e të dhënave parësore. Funkzioni kryesor i analizës dhe gjetjeve paraqitur më poshtë është që të shërbejnë si një bazë përfshirëse e të gjitha perceptimeve dhe botëkuptimeve lidhur me kush bën çfarë dhe në ç'mënyrë në kuadër të punës sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve në vend; problemet që lidhen me burimet njerëzore për kualifikimet dhe mjedisin organizativ; kurrikulën, kërkimet, politikat dhe praktikën e punës sociale; dhe aftësitë, njohuritë dhe interesat për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve në këtë sektor. Këto çështje interesojnë shërbejnë edhe për të ndarë prezantimin e gjetjeve në seksione duke e bërë raportim më të qartë dhe më të lehtë për t'u lexuar.

Panorama e punonjësve të shërbimit social: perceptime dhe kuptueshmëri mbi punën sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri

Perceptimi dhe kuptimi i punës sociale

Profesioni i punës sociale dhe shërbimet sociale kanë një histori relativisht të re në Shqipëri. Kjo, sëbashku edhe me disa faktorë të tjerë kanë bërë që publiku në Shqipëri të mos jetë shumë i informuar dhe të ketë njohuri të kufizuara për profesionin e punës sociale dhe shërbimin e punës sociale. Mendimet që ndajnë praktikantët e punës sociale, edukatorët dhe menaxherët si dhe studentët mbi perceptimet e publikut të gjerë mbivendosen dhe krijojnë një pozicionim të përbashkët mbi publikun si pak i informuar për punën dhe shërbimet sociale.

Ndër faktorët që mendohet se kanë kontribuar në një botëkuptim të varfër të punës sociale nga publiku i gjerë është edhe sistemi i dobët i mirëqenies në vend. Duke qenë se skema e ndihmës ekonomike ka qenë për periudhën pas komunizmit skema kryesore për uljen e varfërisë dhe zakonisht i vetmi "shërbim" për familjet në nevojë, ka ndikuar në reduktimin e konceptit të shërbimit social dhe nëpunësve sociale si **"punonjës së bashkisë që ju japin ndihmën ekonomike njerëzve të varfër"** (Menaxher OJQ, Tiranë). Kjo bën që njerëzit të jenë më të familjarizuar me termin e administratorit social sesa me atë të punonjësit social.

Për pasojë, edhe shumëllojshmëria e profesioneve që janë përfshirë në ofrimin e shërbimeve sociale në vend nuk është kuptuar qartë. Në fakt, si punonjësit

social edhe psikologët ankohen se profesionet e tyre njihen shumë pak dhe po ashtu dihet shumë pak për misionet e ndryshme që përfaqësojnë profesionet e tyre. Punonjësit social sidomos shikojnë progres më të ngadaltë nga ana e publikut për njohjen e profesionit të tyre.

"Zakonisht thonë: 'Oh, je punonjës sociale, që është njësoj si puna e psikologut, apo jo?'" (Student i punës sociale, stazhier në një OJQ, Tiranë)

Sipas arsytimit të tyre, pjesëmarrësit në studim nënvizojnë si faktor tjetër kontribues në këtë situatë edhe hyrjen dhe njohjen e vonuar të punës sociale në radhët e shërbimeve sociale. Megjithatë në Shqipëri, dega e studimeve për punë sociale ka filluar më herët se psikologjia (apo se shkencat e tjera sociale në vend), një vëmendje e dedikuar për të diplomuarit në të këtë profesion erdhi mjaft vonë. Dispozitat ligjore që parashikojnë qartë pozicionet e punës që duhet të punësojnë të diplomuar për punë sociale, janë prezantuar vetëm së fundmi (filluan të artikulohehin me fillimin e reformës së shërbimeve sociale në 2013). Punonjësit e rinj social (me pak muaj eksperiencë pune) dhe studentët që morën pjesë në këtë kërkim u shprehën se ndjejnë se nuk trajtohen në mënyrë të drejtë.

"Si mund të pretendojë dikush se publiku i gjerë është i informuar dhe e kupton punën sociale kur duke filluar që këtu, brenda mureve të fakultetit, kemi profesorë nga fakultetet e ekonomikut dhe juridikut që na mëshirojnë pse kemi zgjedhur profesionin e gabuar si punonjës social, pasi për ne nuk do ketë mundësi pune, madje as tek shërbimet sociale shtetërore, sepse ato i kanë zënë ekonomistët dhe juristët". (Student i punës sociale, Tiranë)

Megjithatë, gjërat vërtet duket sikur po ecin ngadalë, por po shikojnë në drejtimin e duhur për njohjen e punës sociale. Kjo konfirmohet nga punonjës social me më shumë përvojë, të cilët kanë dëshmuar dhe kanë përjetuar zhvillimet që janë shpalosur në këto dy dekadat e fundit. Një nga të diplomuarit e parë për punë sociale në vend e përshkruan në këtë mënyrë:

"Jam nga brezat e parë të punonjësve sociale në vend dhe mund ta shikoj ndryshimin. Kur u regjistrova në degën e punës sociale, shumica e personave nuk e kishin idenë dhe disa prej tyre kishin konceptin e

gabuar se do të merresha me “ushqim social”, një koncept ky që ka ngelur që nga e shkuara komuniste. Tani, kanë kaluar thuajse 20 vjet që nga koha që kanë dalë në treg punonjësit social dhe gjërat kanë ndryshuar në mënyrë drastike.” (Punonjës Social, Organizatë ndërkombëtare)

Por edhe brenda kategorisë së gjerë të opinionit publik, ka një variacion të ndjeshëm midis nëngrupeve, dy prej të cilëve përshkruhen nga pjesëmarrësit si kufizues të niveleve më të larta dhe më të ulëta të njohjes. Komuniteti i shoqërisë civile lidhet me nivelet e larta të të kuptuarit dhe të pranimit të punonjësve social ndërsa përfituesit identifikohen si grupi më pak i informuar dhe ndërgjegjësuar.

Mesa duket arsyet për këtë diferencë janë se organizatat e shoqërisë civile jo vetëm që kanë mesatarisht një edukim më të mirë dhe janë më të informuara, por kanë qenë edhe ‘shtëpia’ e parë për të diplomuarit në punë sociale. Shoqëria Civile ka qenë subjekti kryesor ku u shfaqën shërbimet sociale ‘moderne’ pas ‘90 dhe punëdhënësi kryesor i të diplomuarve për punë sociale (sidomos për dhjetëvjeçarin e parë pas ndryshimeve drastike). OShC kanë qenë të parat që i hapën krahët punës sociale pasi shumë organizata ndërkombëtare që sollën me vete kulturën e tyre të punës, përfshi punonjësit social si pjesë e organgramave e tyre, shërbyen si model edhe për punësimin e punonjësve social vendas. Më rëndësi të veçantë ka qenë edhe ngjarja historie e krizës së refugjatëve kosovarë në 1998-1999, gjatë së cilës ka qenë edhe vala më e madhe e angazhimit të punonjësve social si të punësuar apo si vullnetarë, duke i dhënë kështu më shumë vizibilitet këtij profesioni të ri.

Nga ana tjetër, përfituesit janë kahu tjetër i spektrit të kuptueshmërisë. Arsyet për njohuritë e tyre të pakta mbi punën sociale dhe shërbimet sociale kanë të bëjnë me nivele mesatarisht të ulëta të arsimimit, mungesën e informacionit dhe vulnerabilitetin.

“Përfituesit tanë kryesisht vijnë nga grupe vulnerabël. Nuk dinë shumë për punën në zyra, shërbimet sociale apo profesionalizmin. Zakonisht, ata që vijnë për shërbime aty ku punoj unë, s’e kanë idenë për pozicionin që kam apo profesionin tim. Kur vijnë të kërkojnë ndihmë, bëjnë vetëm një pyetje: “Ku është ajo zonja që ndihmon me x apo y?” (Punonjës i NJMF, Jugu i Shqipërisë)




Fig. 4.1 Nivelet e të kuptuarit të profesionit të punës sociale në Shqipëri

Megjithëse siç është paraqitur grafikisht tek Figura 4.1, publiku i gjerë dhe përfituesit janë ata që duhet të rrisin njohuritë e tyre për punën sociale, parashikimet për të ardhmen duken optimiste. Ligji i ri Nr. 163/2014 mbi “Urdhrin e Punonjësve Social në Republikën e Shqipërisë” që hyri në fuqi në dhjetor të 2014¹⁶ u ndoq me interes të veçantë nga praktikantët e punës sociale dhe ata që aspirojnë të bëhen punonjës social. Ata besojnë se rregullimet e reja të profesionit dhe përfshirja e tij tek profesionet e tjera të rregulluara si mjekësia, farmacia, stomatologjia, inxhinieria, etj. do të ndihmojë për të sqaruar dhe për t’i dhënë më shumë vlera profesionit të punës sociale në nivel kombëtar.

“Besoj se gjërat po ecin në anën tonë. Ligji që rregullon punonjësit social do të sjellë zhvillime të reja për ne. Edhe pse ai mund të kthehet në një dokument të ‘vdekur’ në sirtarët e dikujt, fakti se parlamenti i kushtoi një seancë të plotë në TV, të transmetuar live në disa stacione televizive, për rolin e punonjësve socialë në shoqëri dhe rëndësinë që kishte rregullimi i këtij roli, ja vlejti.” (Studenti i punës sociale, Universiteti i Shkodrës)

Faktorë të tjerë që ndihmojnë në rritjen e vizibilitetit të punës sociale në vend përfshijnë numrin në rritje të profesionistëve të punonjësve sociale që praktikojnë profesionin e tyre dhe të atyre që janë kthyer në rol-modele ose personalitete të rëndësishëm në sektorë të ndryshëm të jetës publike në vend. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, punonjësit social kanë hyrë në Parlamentin shqiptar dhe kanë qenë pjesë e kabineteve qeveritare si ministra. Përvoja e

16 Për më shumë detaje për ligjin shikoni, http://www.parlament.al/ëeb/pub/ligj_nr_163_dt_4_12_2014_20659_1.pdf

grumbulluar e punës sociale dhe kontributi në rritje tek sektorët e ndryshëm po jep rezultate pozitive duke i hapur kufijtë e pranimit dhe kthimit të punës sociale në një profesion të respektuar si gjithë të tjerët. Një nga pjesëmarrësit jep shembullin e punës sociale në shkolla për të ilustruar këtë efekt.

"Mbaj mend kur filluam të afroheshim nëpër shkolla shumë vite më parë. Mësuesit ishin shumë rezistentë. Vinin gjithçka në pikëpyetje: 'Pse jeni këtu? Pse doni të merrni punën tonë? Ne kemi një jetë që kujdesemi për fëmijët tanë dhe nuk kemi nevojë për punonjës social; pse nuk mjaftojmë ne si punonjës social?' Por tani, pas vitesh përkrahjeje nga punonjësit social e kanë parë vlerën e këtij profesioni. Tani, janë ata që na thërrasin për ndihmë sa herë përballen me probleme që nuk lidhen vetëm me procesin e mësimdhënies." (Punonjës Social, OJQ)

Koncepti i punës sociale dhe shërbimeve sociale nuk janë të vetmet që kanë nevojë të kuptohen më mirë.

Mbrojtja e fëmijëve është një koncept tjetër i rëndësishëm që eksploruam për të parë sesi kuptohet dhe adresohet nga publiku i gjerë si dhe nga profesionistët e ngarkuar me detyrën dhe përgjegjësinë e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Perceptimet dhe kuptimi i mbrojtjes së fëmijëve

Koncepti dhe shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve janë diçka e re për publikun e gjerë shqiptar. Koncepti kuptohet në mënyrë shumë të ngushtë si diçka që parashikon ndërhyrjen e shërbimit social shtetëror, policisë dhe personelit të shëndetësisë kur fëmija është në rrezik – ky, një kërcënim ose nga varfëria ose shëndeti i keq, ose nga jashtë familjes (së gjerë). Punonjësit e NJMF-së dhe punonjësit social të OJQ-ve në këtë studim raportojnë se përballen shpesh me barriera të larta qëndrore kur problemi që identifikojnë nuk është tek lista e problemeve që kanë përfituesit, si p.sh dhuna, shfrytëzimi seksual, neglizhimi, etj.

Ky kuptim i ngushtë i mbrojtjes së fëmijëve nuk përfundon me përfituesit. Mentaliteti i përgjithshëm tradicional se fëmijët janë të sigurtë vetëm me prindërit dhe se jeta e tyre private nuk duhet të trazohet nga shërbimet shtetërore, mesa duket e zbeh punën e punonjësve social edhe kur bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë. Ndërsa

koncepti i mbrojtjes së fëmijëve është mjaft i qartë për praktikantët e përfshirë në këtë fushë, ata raportojnë për inkonsistencë në të kuptuarit e këtij koncepti tek profesionistë të tjerë me të cilët duhet të bashkëpunojnë përgjatë menaxhimit të rastit.

"Mendoj se mbrojtja e fëmijëve është për garantimin e të drejtave të fëmijës për t'u mbrojtur nga abuzimi, dhuna, shfrytëzimi, neglizhimi dhe praktika të tjera që venë në rrezik zhvillimin dhe të ardhmen e tyre. Të gjithë e dimë përmendsh këtë, por kur bëhet fjalë në praktikë kemi vështirësi edhe për të kuptuar të gjithë njësoj termin se çfarë është një fëmijë. Njëherë menaxhoja rastin e një vajze 16 vjeçe që ishte abuzuar seksualisht. Më duhet të kisha edhe policinë nga ana ime që të trajtoja rastin, por përgjigja nga policia ishte e pabesueshme! Ai më tha: "Hajde, lëre të shijojë jetën. S'i akuzojmë dot për këtë; nuk do ju kërkojmë njerëzve të bëjnë seks me kartë identiteti në dorë!". (Punonjës social, OJQ)

Të njëjtat probleme konfirmojnë edhe përfaqësues nga OJQ të tjera, të cilat kanë mbështetur ngritjen e mekanizmave shtetëror dhe ndërtimin e kapaciteteve të personelit, e që kanë punuar edhe për të zgjeruar kuptueshmërinë për punonjësit social. Me botëkuptimin dhe veprimet e tyre ata punojnë për mbrojtjen e fëmijëve për t'u fokusuar tek mekanizma më miqësor raportimi dhe referimi, për ta bërë më etik shërbimin, për t'u marrë me çështjen e ndërtimit të besimit dhe konfidencialitetit, të cilat argumentojnë se janë themelore për vende dhe komunitete të vogla si Shqipëria.

Sistemi për mbrojtjen e fëmijës, nga ana tjetër, kuptohet nga edukatorët, menaxherët dhe praktikantët si një set aktivitesh të koordinuara, masash dhe përpjekjesh të aktorëve/institucioneve të ndryshme për të parandaluar, mbrojtur dhe ri-integruar fëmijët në rrezik. Ky perceptim i ndarë mbi qartësinë e konceptit të të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, nuk është domosdoshmërisht i shoqëruar edhe me qartësinë e organizimit të sistemit për mbrojtjen e fëmijëve dhe funksionimin e tij siç vihet re edhe nga përshkrimet e mëposhtme mbi menaxhimin e burimeve njerëzore.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore: kualifikimet & mjedisi organizativ

Pjesëmarrësit në këtë studim, rendisin pikat e mëposhtme si strukturat dhe pozicionet kryesore që kanë përgjegjësi direkte mbi mbrojtjen e fëmijëve:

- Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) pranë njësive të qeverisjes vendore;
- Pikat e kontaktit të barazisë gjinore dhe koordinatorët për dhunën në familje, gjithashtu në nivel vendor;
- Punonjësit social në strehëzat/qendrat e kujdesit rezidencial/qendrat ditore të shoqërisë civile.

Roli dhe përgjegjësia kryesore e tyre përkufizohet e lidhur me identifikimin, vlerësimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve, mbështetur në një plan veprim, që përfshin fëmijën dhe familjen. Profesionistët e tjerë më të rëndësishëm janë oficerët e policisë për të miturit, të pranishëm në çdo komisarjat policie dhe që janë përgjegjës për identifikimin, intervistimin dhe parandalimin e abuzimit në bashkëpunim të ngushtë edhe me profesionistë të tjerë. Rol të ngjashëm kanë edhe psikologët/punonjësit social pjesë e drejtorive të shëndetit publik në nivel rajonal, të cilët merren me identifikimin, vlerësimin, ndërhyrjen dhe koordinimin me profesionistë të tjerë.

Megjithëse këto pozicione janë të ngritura dhe të konsoliduara, mbeten ende probleme me papërputhshmërinë dhe qëndrueshmërinë e personelit. Sidomos pozicionet për punonjësit social profesionist ju jepen shpesh profesioneve të tjera. Edhe pse mungojnë të dhënat kombëtare për të krijuar një tablo të qartë se çfarë bën gjithsecili apo për dallimet që ka një qark nga tjetri, asnjë prej tyre nuk është i përjashtuar nga fenomeni. Duke filluar me Tiranën, ku pavarësisht parashikimit ligjor të Ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" Neni 39, i cili parashikon që çdo Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve të ketë të paktën një punonjës social, kjo kërkesë e detyrueshme me ligj është plotësuar vetëm për 2 nga 11 NJMF-të në Tiranë (deri në qershor 2015).

"Epo, ka dispozita edhe gjithnjë e më shumë punonjësit social po përfshihen në sistem, por mbetemi pakicë edhe vetë brenda sistemit për mbrojtjen e fëmijëve; merr NJMF-të Tiranë, nga 11 NJMF vetëm dy janë

punonjës social me profesion. Çfarë mund të presësh për NJMF-të e tjera në vend?" (Punonjës Social i NJMF-së, Tiranë).

Vetëm në OJQ, stafi që merret me shërbime sociale janë ose punonjës social ose psikologë. Mungesa e arsimit të nevojshme dhe aftësive përshkruhet nga pjesëmarrësit si një kosto e madhe të cilët duhet ta paguajnë imazhi ende i brishtë dhe në konsolidim e sipër i punonjësit social.

"Është shumë pozitiv fakti që po i jepet më shumë hapësirë punës sociale, por nëse kjo nuk mbulohet nga punonjësit social, pak gjasa ka që të jetë e mirë performanca e t'i kontribuojë imazhit më të mirë dhe reputacionit të profesionit" (Edukator, Tiranë)

Për më tepër, nuk është vetëm personeli i NJMF-ve që nuk është kualifikuar siç duhet, por mungojnë ose nuk funksionojnë mirë mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes¹⁷. Gjatë diskutimeve në fokus-grupe, punonjës socialë profesionistë si dhe profesionistë të tjerë të shërbimeve sociale (kryesisht juristë dhe ekonomistë) debatuan lidhur me ekzistencën e mekanizmave të monitorimit dhe funksionimit; megjithatë, të gjithë ranë dakord se ka një mungesë të plotë të mbikëqyrjes/supervizimit profesional. Një punonjëse sociale nënvijëzoi se një nevojë shumë e madhe për të cilën flitet shumë pak është ajo për supervizim profesional të punës sociale; një koncept ky i panjohur për profesionistët e tjerë që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve.

Të gjithë punonjësit e NJMF-ve bien dakord për një kufizim tjetër të përbashkët të punës së tyre, që është të bashkosh dhe të koordinosh me aktorë të tjerë, të cilët me ligj duhet të marrin pjesë tek grupet multi-disiplinare që ngrihen dhe koordinohen nga punonjësi social i NJMF-së.

"Ligji na ngarkon me detyrën e ngritjes dhe koordinimit të grupit multi-disiplinar për të adresuar rastet e fëmijëve në rrezik, por ndjehemi të pafuqishëm. Nuk ka mekanizma që të detyrojnë aktorët e ndryshëm që të ulen bashkë kur kemi nevojë për ta dhe kjo kërkon

17 Ka një set standardesh që duhen të plotësohen dhe monitorohen gjatë aktivitetit të shërbimit social shtetëror që përfshijnë edhe kategorinë e fëmijëve. Megjithatë, këto standarde i referohen në veçanti fëmijëve në institucione rezidenciale. (Shiko Shërbimin Social Shtetëror tek faqja <http://www.sherbimisocial.gov.al/standardet-per-sherbimet-shoqerore/>).

shumë kohë dhe energji të punës sonë të përditshme.”
(Punonjës NJMF, Tiranë)

Midis gjithë aktorëve që duhet të bashkëpunojnë, pjesëmarrësit nënvizojnë policinë si më të përgjigjshmen dhe shkollat dhe drejtoritë arsimore si pak të tilla. E kanë të vështirë të gjejnë arsytet për këto dallime reagimesh dhe masash nga institucionet e ndryshme partnere. Megjithatë, disa arrijnë në përfundimin se kjo mbase varet edhe nga vetë individët dhe angazhimi i tyre për të marrë punën seriozisht.

“Është makth të punosh me institucionet arsimore. Rrallëherë vijnë në grupet multi-disiplinare. Edhe kur vijnë, ulen aty dhe nuk thonë asgjë. Nuk e kuptoj a është refuzim apo mungesë dëshire për të kontribuar.”
(Punonjës Social, Vlorë)

Shumica e punonjësve social përdorin rrjetet e tyre për ta bërë punën. Por, as kjo nuk është strategji e qëndrueshme. Numri i lartë i ndërrimit të stafit tek institucionet shtetërore nuk të lejon të ndërtohet dhe të mbash marrëdhëniet me aktorët e ndryshëm. Për më tepër, kjo ndikon negativisht tek niveli njohurive, ndërgjegjësimit dhe gatishmërisë për t’ju përgjigjur nga ana e personelit të institucioneve të tjera.

“Punësimi tek shërbimet sociale përdoret si shpërblim për militantët e partive politike kur partia e tyre vjen në pushtet. Kjo sjell paqëndrueshmëri dhe kapacitete të dobëta në shërbim. Njëherë punova shumë me një oficer policie për të miturit në zonën time. Kur e ndihmova të kuptonte më mirë rolin e tij dhe e binda të kontribuonte, atë e transferuan tek një komisarjat tjetër. M’u desh të filloja nga e para me një oficer të ri, por kjo ma shkatërroi punën e deriatëhershme për menaxhimin e rastit.” (Punonjës social, OJQ, Tiranë)

E fundit, por jo për nga rëndësia, ofrimi i shërbimeve sociale në përgjithësi dhe shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve në veçanti pengohen nga burimet e kufizuara dhe infrastruktura e varfër. Disa punonjës të ndryshëm të NJMF-ve raportojnë se nuk kanë ambiente pune, e ndajnë zyrën me programe të tjera si “Ndihma ekonomike”, nuk kanë kompjutera apo internet dhe duhet të paguajnë nga xhepi transportin dhe shpenzimet e punës në terren.

“Punojmë në kushte shumë të vështira. E ndaj zyrën me punonjës të ndihmës ekonomike. Të paktën 10

ditë në muaj nuk kam vend as të rri në këmbë në zyrë se është plot me njerëz që kërkojnë asistencë. Mos të flas pastaj për faktin që nuk kam as tavolinë, as kompjuter, përdor timin, nuk kam raftë për dosjet. Shyqyr që kam makinë vetë dhe e kam kthyer në arkiv. Kjo nuk është as efektive dhe as profesionale. Kur zyra është plot, dua s’dua klientët i takoj jashtë në të nxehtë dhe në të ftohtë. As kjo nuk është profesionale!” (NJMF, Tiranë)

Ndërkohë që për NJMF-të në Tiranë, OJQ-të e shumta në kryeqytet kanë ndihmuar për të mbuluar shumë nga mangësitë në infrastrukturë dhe burime të kufizuara, situata jashtë Tiranës është edhe më keq.

“Këtu në Vlorë duhet t’i mbulojmë rastet edhe nga zonat rurale. Unë nuk kam makinë. Ndonjëherë marr taksì, por se përballoj dot gjithmonë. Shumicën e rasteve i shtyj dhe pres të vij ndonjë organizatë nga Tirana për ndonjë vizitë në terren që të përdor burimet e tyre.” (Punonjës Social, Vlorë)

Vështirësitë operacionale janë për shkak të nxitjes së ulët financiare që marrin punonjësit. Raportohet se rroga mujore është pak më e lartë se ajo e personelit të mirëmbajtjes tek institucionet përkatëse. Kombinimi i të dyjave bën që ky pozicion të shikohet si një punë e përkohshme, sidomos për juristët dhe ekonomistët, që thonë se e bëjnë këtë punë se e kanë të vështirë të gjejnë punë tjetër në zanatin e tyre dhe kërkojnë gjithmonë mundësi për të ndryshuar punë.

Arsimimi: kurrikula, kërkimet, politikat, praktika

Kurrikula

Punonjësit socialë profesionistë trajnohen formalisht në tre universitete shtetërore që ofrojnë programe të ndryshme bachelor dhe master, si të nivelit profesional edhe të atij shkencor (më shumë detaje për programet gjenden tek seksioni i rishikimit të literaturës të këtij raporti). Megjithatë, siç u theksua më sipër kur u diskutua çështja e burimeve njerëzore për shërbimet sociale, punonjësit e kualifikuar socialë edhe pse po rriten në numër brenda sistemit të shërbimit social, vazhdojnë të mbeten një pakicë krahasuar me ata që nuk janë profesionistë.

Punonjësit social profesionistë dhe ata jo-profesionistë sapo hyjnë në sistem janë subjekt trajnimesh të vazhdueshme dhe ngritje kapacitetesh

që organizohen nga institucionet shtetërore në bashkëpunim me universitetet dhe OJQ-të. Megjithatë, i vetmi kurs i formalizuar është kursi në proces akreditimi për Mbrojtjen e Fëmijëve, një program që është zhvilluar nga MMSR, Universiteti i Tiranës dhe një grup OJQ-sh (përfshirë Terre des hommes, World Vision Albania, Save the Children dhe UNICEF).

Pjesëmarrësve në këtë studim ju kërkua të ndajnë përvojat dhe mendimet e tyre mbi kurrikulat e këtyre mundësive arsimore për punonjësit social në Shqipëri.

Brezi i parë i të diplomuarve për punë sociale vlerësoi kurrikulën mjaft solide të "importuar nga Sh.B.A" që ju ishte ofruar. Ata e vlerësuan këtë kurrikulë të parë si gjithëpërfshirëse dhe që reflektonte më të mirën e disiplinës së tyre. Megjithatë, kjo ishte një paketë e plotë që kishte edhe kufizime për shkak të burimeve të pakta të literaturës në gjuhën vendase dhe ilustrimet e shembujt nuk përputheshin me mjedisin vendas. Me kalimin e viteve, literatura për punën sociale u rrit, por vazhdojnë problemet e dallimit midis teorisë dhe kontekstit shqiptar.

"Kur u regjistrova në një program masteri para dy vitesh, shpresoja të gjeja përgjigje për dilemat me të cilat përballem në punën time si punonjës social. Por, u zhgënjëva kur pashë se nuk kishin ndryshuar shumë gjëra që nga koha kur isha diplomuar. Vazhdonin

shembujt që i referoheshin Amerikës ose Anglisë dhe kishte shumë përsëritje teorike dhe të koncepteve – të njëjtat që përfshihen në të gjitha kurset që kam marrë pjesë. Më e bukura ishte që lëndën e jepte dikush që nuk ka asnjë ditë praktikë në profesion". (Punonjës Social, OJQ, student në programin master)

Megjithatë, kurrikula e punës sociale duket sikur është në krye të listës së profesioneve të tjera përsa i përket nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve që ngre tek studentët. Të intervistuarit tanë argumentuan se, me gjithë kufizimet e veta, programi i punës sociale i pajis studentët me njohuritë më të mira dhe aftësitë për të punuar tek shërbimi social dhe me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve.

"Punoj me kolegë nga disiplina të ndryshme, madje edhe psikologë që janë më afër arsimimit tonë dhe shpesh na kanë 'zili' për aftësitë dhe shprehjet praktike që kemi para se të fillojmë punën". (Punonjës social, OJQ, Tiranë)

Ky dallim mund të vihet re kur menaxhojnë rastin punonjësit profesionistë dhe jo-profesionistë që punojnë si specialistë për mbrojtjen e fëmijëve. Historitë e rastit u përdorën për të kuptuar më mirë sesi ata që praktikojnë punën e punonjësit social përdorin trajnimin dhe arsimimin e tyre në jetën reale; Rasti 1 dhe Rasti 2 paraqesin dy eksperiencat të ndryshme praktike pune.

Rasti #1. Praktikë e mbrojtjes së fëmijës nga një punonjës social jo-profesionist

Ajo është specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) në një nga zonat administrative të Tiranës (megjithëse strukturat e qeverisjes vendore janë në ristrukturim e sipër). Tek të 50-tat nuk ndan shumë për informacionin demografik dhe për arsimimin dhe nuk do ta regjistronjë duke shpjeguar se pak muaj ka në këtë detyrë dhe nuk do të rrezikojë (nënkupton që "regjistrimi mund të përdoret në ndonjë mënyrë kundër meje nëse i bie në dorë dikujt që do të më zëvendësojë me ndonjë militant; për shënimet ok, vetëm me shënime ju besoj.") Ajo e përgjithëson duke thënë se është e re në praktikën e punës sociale pasi me profesion është ekonomiste. Megjithatë, duke qenë plotësisht e informuar për qëllimin e studimit ajo thekson se "edhe pse nuk jam punonjëse sociale me profesion, jam punonjëse sociale me zemër dhe në praktikë."

Zgjedh të më shpjegojë një rast që ka identifikuar gjatë një 'inspektimi' në terren. "Rastet i identifikoj kur dal nga zyra. Ky ka qenë edhe rasti që do ju përshkruaj." Rasti i referohet një nëne dhe 9 fëmijëve të saj që kalonin shumë kohë tek koshat e plehrave afër zonës ku është zyra. "Megjithëse nuk kishin dalë ende udhëzimet për fëmijët në situatë rruge, vendosa të merresha me këtë familje pasi mendova se fëmijët janë në situatë rruge." Pasi kontaktoi nënën menjëherë tek vendi ku kërkonin mbetje për të ricikluar, ajo mori vesh për situatën e

vështirë në të cilën ndodheshin dhe të ardhurat familjare dhe vendosi të bënte një vizitë tek barakja e tyre. Ajo tha se e mori vendimin për të bërë vizitë në terren për t'u siguruar që 'nuk po gënjenin' duke thënë se ishin më keq nga ç'ishin vërtet. Pasi bëri verifikimin vendosi se familja ishte vërtet në nevojë dhe fëmijët kishin nevojë për mbrojtje. U thirr grupi multidisiplinar për të diskutuar dhe për të rënë dakord mbi planin e ndërhyrjes.

Takimi i grupit multi-disiplinar vendosi të bënte një vizitë tjetër në familje dhe të ndante detyrat specifike për çdo institucion, të cilat s'i kujtonte të gjitha specifikisht. Hapat e ndjekur me tej dhe vendimet e mara për menaxhimin e rastit shpesh janë udhëhequr nga paragjykime. "E ndoqa rastin nga afër. Ata kishin një baba të alkoolizuar që nuk ofronte asgjë kështu që e përfshimë familjen tek ndihma ekonomike. I kërkova mamasë të më sillte të paktën një fëmijë me vete çdo muaj kur të merrte ndihmën që të shikoja si ishin fëmijët. Ky ishte një lloj monitorimi, sepse mund të gjykoja me sy se ishin më mirë; ishim më të veshur, të larë, të ushqyer."

Duke eksploruar më tej këtë rast përmes pyetjeve të tjera, ajo pranon se nuk është marrë me nevojat specifike të gjithsecilit prej 9 fëmijëve. "Nuk bëra vlerësim individual për çdo fëmijë. Ishin djem dhe vajza. Djemtë i çuam në shkollë, ndërsa vajzat preferonin që t'i mbanin në shtëpi. Edhe ato donin të rrinin në shtëpi, kështu dukej që ju pëlqente."

Duke ju referuar çështjes së mundësisë për dhunë në familje, ajo ishte kontradiktore në deklaratat e saj. Ajo besonte se nuk kishte asnjë mundësi që babai të ishte i dhunshëm me fëmijët se "ishte i dobët dhe pafuqi saqë njerëzit pyesnin nëse ishin të tijtë." Megjithatë, duke mbyllur rastin tha se kishte parë shenja dhune tek mamaja. "Tani nuk kam informacion. Kanë ikur në Shkodër. Mbase i shfrytëzon atje, duhet të marr ndonjë ditë informacion nga zyra e Shkodrës ...".

Kur u pyet se përse nuk e kishte bërë edhe pse kishte muaj që s'e shikonte mamanë të vinte të merrte ndihmën ekonomike, ajo foli për mungesën e vendit të punës dhe burimeve si arsye kryesore "ke të drejtë që ma bën këtë pyetje, por është e vështirë të ndjekësh çdo gjë; çfarë mund të bësh pa një zyrë tërë, pa vend pune, pa kompjuter, pa internet, pa buxhet për udhëtime ...".

Pavarësisht dyshimit të saj për ato që po ndodhnin me familjen dhe fëmijët, ajo e konsideron si një rast të suksesshëm përse kohë u menaxhua prej saj "pasi qëllimi që të hiqeshin fëmijët nga rruga u arrit".

E ka të vështirë të lidhë arsimimin e saj me rastin dhe thekson se komunikimi është çelësi dhe trajnimet e shumta e kanë ndihmuar për të forcuar kapacitetet e nevojshme dhe zotësitë për të shërbyer mirë si punonjëse për mbrojtjen e fëmijëve.

Rasti #2. Punonjës social profesionist – praktikë për mbrojtjen e fëmijëve në një OJQ

Kjo histori tregohet nga një punonjës social profesionist që punon për një OJQ në Tiranë. Ajo është 29 vjeç dhe ka mbaruar studimet universitare si dhe ato master për punë sociale. Ajo ka disa vite eksperiencë dhe i duhet pak kohë për të vendosur se cilin rast do të ndajë më ne. Më në fund, vendos për një rast të që ka menaxhuar dhe mendon se është i 'vështirë'.

"Ky është rasti i një adoleshenteje që ka ikur nga shtëpia pasi dhe kishte qenë viktimë e abuzimit seksual nga kushëriri i saj, një fakt që mamaja refuzonte ta besonte pasi nuk donte të prishte marrëdhëniet e 'mira' me vëllain e saj, babain e abuzuesit. Të dyja familjet jetonin afër njëra-tjetrës dhe mamaja mbështetej shumë tek ndihma financiare dhe morale e vëllait të saj, ndërkohë që i shoqi-babai i viktimës ishte në emigracion."

Punonjësja sociale e kujton dhe e organizon ndarjen e historisë së rastit me faza. Ajo sqaron të gjitha hapat që u ndërmorën dhe kur pyetet për arsyetimin dhe çfarë ka ndikuar procesin e vendim-marrjes, ajo kombinon arsimimin e saj me eksperiencën dhe rrethanat kufizuese.

Faza 1 – Referimi i rastit

Policia mori në telefon OJQ ku punoj unë. Edhe pse ishte mesi i natës shkova të asistoj policinë se nuk kanë asnjë staf të specializuar për të intervistuar të mitur, sidomos viktimat e trafikimit, abuzimit seksual, etj. Rasti u regjistrua dhe ju kërkua OJQ-së sime ta strehonte derisa të përgatitej plani. Mbështetur tek historia që tregoi u vendos që kthimi në shtëpinë nga ishte larguar dhe ku kishte qenë viktimë e abuzimit seksual nuk ishte i sigurt.

Faza II – Vlerësimi i rastit

Në qendër, kur e mori OJQ ku punoj unë, vendosa të filloj menjëherë me vlerësimin e rastit. Ishte mision i vështirë se vajza nuk besonte asnjë dhe refuzonte të pranonte se mund ishte në

një situatë vulnerable për t'u shfrytëzuar nga të huajt ndërkohë që rrinte larg shtëpisë. Gjëja e parë ku u fokusova ishte ndërtimi i besimit. Ndërkohë, u përpoqa t'i shpjegoja rreziqet dhe sesi është e mundur për një vajzë të moshës së saj që largohet nga shtëpia të binte viktimë e trafikimit dhe abuzimit.

Duke i përsëritur se të gjithë aty ishim për ta ndihmuar të udhëhequr nga interesi i saj më i lartë, nënvizova se ishte në dorën e saj të vendoste nëse mendonte se ishte më mirë të kthehej në familje. Vendosi të përballej me prindërit dhe t'i bënte ata që të raportin rastin, përndryshe nuk do të kthehej më në familje.

Faza III - Përballja me prindërit

Duke vazhduar me vlerësimin e rastit dhe sipas vendimit të saj për t'u përballur me familjen, u organizua një vizitë në familje të nesërmen. Gjatë përballjes me prindërit (edhe i ati ishte kthyer nga Greqia pas ikjes së saj nga shtëpia) dhe kur ju kërkoi ta denonconin, ajo tregoi edhe informacion tjetër se kushëriri nuk kishte abuzuar vetëm atë, por ishte përpjekur të bënte të njëjtën gjë edhe me vëllain e vogël. Kjo kishte qenë pika, sipas saj, kur kishte vendosur të mos e pranonte më dhe të largohej.

Faza IV: Raportimi i abuzimit

Familja ra dakord dhe u asistua që të ngrinte akuza kundër abuzuesit. U bënë ekzaminime mjekësore pas raportimit, të cilat konfirmuan se abuzimi kishte ndodhur.

Faza V: Ribashkimi me familjen

Pas konfirmimit të abuzimit dhe denoncimit të abuzuesit ajo u pajtua me prindërit dhe vendosi të kthehej në shtëpi.

Faza VI: Ndjekja e rastit

Që nga ajo kohë, ajo u arratis edhe disa herë të tjera dhe u ndoqën të njëjtat procedura, por policia nuk ishte më bashkëpunuese. Ata thanë se nuk do merreshin gjithë kohën me atë. Megjithatë, OJQ-ja dhe përpjekjet e mia vazhduan derisa hyri në një qendër për gratë në rrezik trafikimit dhe dhune në familje. Aty e mori përsipër rastin një

punonjës social i qendrës. Vazhdonin të më informonin dhe mora vesh se marrëdhëniet me familjen nuk ishin stabël, sepse (mbase se ju kishin bërë presion) kishin tërhequr akuzat për kushëririn abuzues. Gjatë kësaj periudhe nga qendra në familje dhe anasjelltas kishte rënë në dashuri me një djalë nga lagja. Herën e fundit që e takova ishte kur më erdhi në zyrë dhe më falënderoi për mbështetjen që i kisha dhënë dhe më tha se ishte mirë dhe se ishte shtatzënë.

Duke reflektuar për rastin punonjësja sociale nuk është e kënaqur me mënyrën si shkoi. "Nuk u kthye më në shkollë dhe u martua në moshë të hershme. Megjithëse më bëhet qejfi që është shtatzënë, mendoj se po të ishin koordinuar më mirë aktorët mund të kishte pasur një mundësi të dytë për shkollim dhe marrëdhënie më të shëndetshme me familjen. Policia nuk arriti të merrej me rastin e saj kur ishte e nevojshme, drejtësia dështoi kur la prindërit të tërhiqnin akuzat edhe pse rezultatet mjekësore konfirmuan abuzimin, prindërit nuk e besuan historinë e saj dhe nuk e mbështetën.....a mund të kisha bërë gjë? Mbase, por në atë kohë përdora gjithë njohurinë dhe burimet që kisha. Ndonjëherë shpresoj të isha njëkohësisht edhe juriste edhe police... por vetëm dëshirë"

I gjithë procesi që kishte ndjekur dhe vendimet u mbështetën tek njohuritë dhe aftësitë që kishte marrë gjatë studimeve për punë sociale ndër të cila përmendi:

- Intervistimin
- Praktikën e punës sociale me fëmijët dhe familjet
- Rastet studimore
- Etikën në punën sociale

Gjatë vënies në praktikë të njohurive dhe aftësive ajo zbuloi se gjithçka mund të përmirësohet me më shumë mbikëqyrje/supervizim profesional. Supervizimi profesional mungon ose është shumë i rrallë. Krahas kësaj, njohuria mbi ligjet është një tjetër pikë e dobët.

Diskutimet në fokus-grupe me studentët e punës sociale kontribuuan për të kuptuar më mirë dallimet e kurrikulave në shkencat sociale, por edhe brenda disiplinës së punës sociale. Programet universitare në Shkodër dhe Elbasan janë mbështetur tek ai i Tiranës. Si rezultat, programi universitar i Tiranës ka shërbyer edhe për ata si një bazë e mirë; megjithatë, studentët përmendin disa dallime të rëndësishme që kanë identifikuar duke bërë studimet *bachelor* tek njëri universitet dhe ato *master* tek universiteti tjetër.

“Në Shkodër kemi kurrikulë të fortë, por është më shumë psikologji. Ka shumë ndikim departamenti i psikologjisë tek puna sociale. Si di arsyet dhe dinamikën, por ky është rezultati” (Student masteri, Bachelor në Shkodër dhe Masteri në Tiranë)

Po ashtu kurrikulumi i punës sociale në Elbasan pretendohet se anon më shumë nga psikologjia dhe shkencat e edukimit.

Përsa i përket përmbajtjes së kurrikulimit, të drejtave të fëmijëve dhe çështjeve për mbrojtjen e fëmijëve, të intervistuarit identifikuan dhe rendisnin një numër kursesh me fokus tek praktika e punës me fëmijët dhe tek puna sociale ku përfshinin “Sjellja njerëzore dhe mjedisi social” “Shprehitë e punës sociale” “Puna Sociale me fëmijët dhe familjet” “Puna sociale në shkollë” “Politika sociale” etj. Megjithatë, perceptimi i tyre për çështjet e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre është se, megjithëse është përfshirë në disa kurse, problemet e fëmijëve trajtohen sipas filozofisë që e shikon fëmijët si pjesë të familjes dhe shumë pak vëmendje i kushtohet ekskluzivisht fëmijës. Ndërkohë që kjo përgatit studentët e punës sociale që të jenë gati për të punuar me fëmijët si pjesë e një sistemi, duke filluar me familje, kjo nuk ua lehtëson punën kur përballen me një rast të mbrojtjes së fëmijës ku problemi është pikërisht familja.

Kërkimet

Një perceptim i zakonshëm midis pjesëmarrësve në këtë kërkim ishte rëndësia për të pasur më shumë njohuri dhe aftësi për kërkime si studjues social në përgjithësi dhe si punonjës social në veçanti, përfshirë punën me fëmijët. Duke ju referuar përvojës së tyre arsimore ata thanë se nuk ishin plotësisht të sigurtë për njohuritë dhe aftësitë e tyre për kërkim për shkak të një sërë faktorësh.

Fillimisht, jo të gjitha programet e punës sociale në vend vendosin theksin e nevojshëm tek metodat kërkimore dhe produktet e kërkimeve. Ndërkohë që studentet *bachelor* të departamentit të punës sociale në Universitetin e Tiranës ekspozohen që herët ndaj metodave kërkimore dhe i ri-vizitojnë metodat kërkimore, si ato sasiore dhe cilësore, tek të gjitha nivelet e studimit (si p.sh gjatë programeve master), studentët që janë diplomuar në një nga shkollat e tjera në vend raportojnë se janë ekspozuar vetëm ndaj lëndëve hyrëse në metoda.

Pavarësisht avantazhit të programit që raportojnë studentët dhe të diplomuarit e punës sociale në Tiranë, kur fjala vjen tek aftësitë dhe shprehitë për të përgatitur dhe realizuar një kërkim, ky dallim ngushtohet. Në të gjitha rastet, ka nevojë për një theks më të madh në komponentin praktik të kërkimit në të gjitha programet e punës sociale në vend.

“Nuk mund të ankohe mi kur vjen fjala tek kërkimi. Ka qenë një komponent kryesor i kurrikulës sonë; megjithatë, nuk jam shumë i sigurt se nuk kemi pasur shumë mundësi ta praktikojmë. Atëherë, por mendoj se nuk ka ndryshuar situata, nuk kishte laboratorë me kompjutera dhe as programe për të analizuar të dhënat. Gjithsej na jepej një detyrë kursi po që asnjë nga ne nuk ishte shumë i mirë tek kjo detyrë” (Punonjës social, Tiranë)

Nga një dimension tjetër, rezultatet e kërkimit, sidomos ato në vend, prezantohen në mënyrë sporadike gjatë procesit mësimor. Përgjigjedhënësit shpjegojnë se ky është rezultat i kombinimit të një roli jo shumë pro-aktiv të stafit mësimor për të eksploruar dhe për të sjellë shembuj nga Shqipëria, numrit relativisht të vogël të produkteve kërkimore në vend, si dhe cilësisë të tyre shkencore përgjithësisht të dobët. Ky është qëndrimi i një edukatori për mënyrën sesi shihen kërkimet vendase:

“Po, përpiqem t’i referohem literaturës dhe kërkimeve vendase sa më shumë të kem mundësi, por nuk është e lehtë të gjesh kërkime shkencore të plota nga autorë shqiptarë. Sidomos për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, shumica e raporteve vendase (zakonisht të përgatitura nga OJQ-të) janë kërkime të aplikuara, kanë një kapitull të shkurtër metodologjie nga i cili nuk mund të kuptosh dhe replikosh shumë, ose kanë probleme etike serioze. Nuk po them që nuk ja vlejnë, përkundrazi, falë Zotit për OJQ-të që e kanë

ngushtuar atë boshllëkun e kërkimeve vendase, por për lëndët që jap metodat janë të rëndësishme, me duhen shembuj të mirë që t'ia tregoj studentëve. I ve të lexojnë kërkime që kalojnë në proces rishikimi. Një herë u kërkova të angazhoheshin me rishikimin e punimeve të autorëve shqiptarë. Nuk funksionoi dhe aq mirë se u fokusuan tek autori dhe njëherë një student më tha "si mund të kritikosh punën e X ai është një profesor me emër!" (Edukator, Tiranë)

Nga ana tjetër, menaxherët dhe politikë-bërësit ja venë gishtin subjektit në rritje të kërkimeve 'lokale' që duhet të gjejnë më shumë hapësira tek mësimdhënia e punës sociale në vend. Synohet që të ketë më shumë referenca për rezultatet e kërkimeve lokale, pra që ajo që studentët mësojnë në shkollë të jetë më afër realitet, me të cilin do të përballen herët a vonë kur të fillojnë punën.

"Kërkimi është shumë i rëndësishëm dhe duhet bërë më shumë që të përfshihet jo vetëm tek programet bachelor dhe master, por edhe tek trajnimet që i bëhen stafit të shërbimeve sociale. Kjo duhet të jetë e detyrueshme sidomos për ata që punojnë me vlerësimint." (Edukator dhe menaxher, Tiranë)

Kjo analizë është e dobishme për të diplomuarit për punë sociale. Duke marrë në konsideratë se shërbimet sociale shpesh kryhen edhe nga punonjës që nuk janë të punës sociale, ka një nevojë të jashtëzakonshme për të trajnuar stafin ekzistues me programe që kanë një ekuilibër të mirë midis teorisë, aftësive dhe praktikës. Kjo nuk vlen vetëm për ofruesit e shërbimeve sociale shtetërore, por edhe për OJQ-të dhe bizneset sociale (që kanë filluar rishtazi).

"Mendoj se njohuritë dhe aftësitë për kërkim po bëhen çdo ditë e më të rëndësishme. Edhe në punën tonë duhet të vërtetojmë se jemi eficient, na duhen prova për të kërkuar më shumë mbështetje qoftë në një drejtim apo tjetrin. Financimet nga donatorët sa vijnë e pakësohen dhe na duhen evidenca më të forta dhe të besueshme për të kërkuar fonde për të mbështetur shërbimet tona." (Punonjës social dhe menaxher OJQ, Tiranë)

Politikat

Individët që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve mësojnë në tre mënyra kryesore për politikën përkatëse dhe legjislacionin. Një mënyrë është ekskluzivisht për ata

që kanë studiuar shkencë sociale dhe sidomos punën sociale si pjesë të kurrikulës. Dy mënyrat e tjera lidhen me vendin e punës. Trajnimet dhe aktivitetet e tjera për ngritjen e kapaciteteve, si seminarët dhe workshop-e, përkrah dokumenteve informues që qarkullojnë (nëpërmjet Fletoreve Zyrtare, Urdhrave të Ministrave, etj.) për ligjet e reja që kanë kaluar apo politikën që përgatiten, synojnë që t'i mbajnë të informuar. Megjithatë, nuk mund të thuhet me siguri nëse arrihet qëllimi në të gjitha rastet.

Nëse fokusohemi tek kurríkula dhe edukimi, gjejmë se politika sociale dhe legjislacioni kanë zënë një hapësirë të rëndësishme në programet e punës sociale. Tek kurríkula e punës sociale, të diplomuarit e ardhshëm mësojnë për politikën sociale si disiplinë dhe proces, ata familjarizohen me kuadrin ligjor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Pjesë e këtyre janë edhe çështjet që lidhen me fëmijët. Punonjësit sociale mësojnë për politikën aktuale që adresojnë mirëqenien e fëmijës si dhe familjarizohen me kuadrin ligjor për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë, ka vend për përmirësim edhe kur bëhet fjalë për politikën në kurríkulën e punës sociale. Studentët dhe të diplomuarit pranojnë se edhe pse politika dhe legjislacioni zënë pjesën më të madhe të programit të tyre, shumica e njohurive që marrin janë vetëm të përkohshme. Nuk përfshihen mënyrat sesi dhe ku të kërkosh politikën dhe ligjet e reja.

"Në programin tonë ne kemi pasur disa lëndë të ndryshme të politikave sociale dhe legjislacionit brenda të cilave kam mësuar edhe për politikën e ndryshme dhe ligjet që lidhen me fëmijët. Më kujtohet se kemi mësuar për konventat e ndryshme mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, kodet e ndryshme, strategjitë dhe politikën, por informacioni ishte i dobishëm vetëm për atë kohë. Tani kanë ndryshuar shumë gjëra dhe të gjitha ato që i kisha mësuar përmendësh nuk më shërbejnë në punën që bëj tani." (Punonjës social, Fier)

Krahas kësaj, nga këndvështrimi i pedagogëve dhe menaxherëve, thellësia dhe shtrirja e mënyrës sesi trajtohen ligjet dhe politikën për fëmijët tek programet universitare të punës sociale, janë të mjaftueshme si bazë e përgjithshme, por nuk janë të mjaftueshme për punonjësit social që duan të merren me shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve. Disa prej tyre rekomandojnë lëndë më të specializuara

dhe specializime të mëtejshme për t'i përgatitur për praktikë.

Praktika

Aftësitë dhe kompetencat thelbësore për praktikën e mbrojtjes së fëmijëve jepen ekskluzivisht tek programet e punës sociale. Ato variojnë nga shprehite e intervistimit (përfshirë dëgjimin aktiv, empatinë, etj.) dhe deri tek shprehite bazë të këshillimit, vlerësim rasti, vlerësimin dhe aftësitë për menaxhim, aftësitë dhe kompetencat për të punuar me fëmijët dhe kështu me radhë. Shpesh, teoria kombinohet me praktikë në klasë si për shembull përmes lojës me role. Megjithatë, praktika dhe praktikumi mbeten orët më të rëndësishme ku studentët mund të praktikojnë njohuritë dhe shprehite që kanë marrë.

Për pedagogët, problemi kryesor është kohëzgjatja e praktikës. Sipas tyre, programi 3-vjeçar *bachelor* ka reduktuar shumë orët e praktikës që duhet të bëjnë studentët para se të diplomohen dhe të përgatiten për punë. Për studentët e punës sociale dhe të diplomuarit praktika sasia e praktikës është më pak problem krahasuar me cilësinë e saj. Ata argumentojnë se përballen me një sërë problemesh që lidhen me praktikën ku përfshihen:

- a. **Vështirësi për të gjetur dhe për të zënë vend praktike tek ndonjë ofrues shërbimesh sociale** (institucion shtetëror, OJQ, apo ndonjë tjetër).

"Shpesh na duhet të kërkojmë vetë për të gjejmë një vend për praktikën. Duhet të njohim njerëz, të kemi lidhje, që të gjejmë një vend ku të paktën të shikojmë si bëhet praktika, jo më të praktikohemi vetë" (Student)

- b. **Mungesa e mbikëqyrjes/supervizimit (të mirë).** Studentët pretendojnë se neglizhohen gjatë kohës që dalin në terren si nga mbikëqyrësi i universitetit dhe nga ai ku po kryhet praktika. Mungesa e mbikëqyrjes profesionale vazhdon edhe pas diplomimit, kur janë të punësuar, siç u nënvijëzua edhe në seksionin mbi burimet njerëzore në këtë raport.

"Është thjesht formale. Nuk i bëhet vonë askujt; supervizori i universitetit shikon vetëm letrat dhe na ve notën, ndërsa supervizorët e institucionit nuk ka

asnjë shtysë financiare dhe na shikojnë si barrë. Veç kësaj, sidomos tek institucionet shtetërore nuk janë as profesionistë të punës sociale dhe na shikojnë si kërcënim. Përpiqen të na shmangin duke bërë si të mirë dhe thonë se nuk kemi pse të shikojmë përditë apo të rrimë të gjithë kohën e parashikuar atje." (Student, Tirana)

- c. **Koordinim i varfër institucional.** Nuk ka asnjë mekanizëm për të rregulluar marrëdhëniet institucionale midis universiteteve dhe ofruesve të shërbimeve sociale. Si rezultat, praktika mbështetet tek marrëveshje sporadike dypalëshe, të cilat duhet të negociohen çdo vit. Megjithatë, si pedagogët dhe menaxherët shpresojnë se me zhvillimet e reja dhe me rregullimin e profesionit të punës sociale, do të rregullohet shpejt edhe praktika. Pedagogët konfirmuan se po përpiqen edhe të rrisin edhe sasinë e orëve të praktikës tek programi i punës sociale të Universitetit të Tiranës.

- d. **Spektri i ngushtë i praktikës.** Edhe kur praktika shkon mirë dhe qetë, mbetet problem fakti që kontribuon vetëm pjesërisht tek aftësitë dhe kompetencat e punonjësve të ardhshëm të punës sociale. Duke qenë se studentët shpesh i çojnë vetëm tek një ose dy ofrues shërbimesh, ata mësojnë vetëm praktikën e punës me një kategori përfituesish, e cila nuk i përshtatet domosdoshmërisht punës së tyre të ardhshme. Kjo bën që shumica të mbështeten tek qasja "të mëson puna vetë" dhe tek mundësi sporadike të edukimit në vazhdim që mund të dalin kur fillojnë punë.

Edukimi në vazhdim vlerësohet shumë pasi shërben si urë lidhëse midis shkollimit të stafit ekzistues dhe njohurive dhe aftësive që ju duhen për të bërë mirë shërbimet e punës sociale dhe ato për mbrojtjen e fëmijëve. Rasti numër 3 na u tregua nga një punonjës social i një OJQ-je të arsimuar pjesërisht në punë sociale; me një profesion fillestar të ndryshëm nga puna sociale ky rast na shpjegon sesi u përmirësua praktika e saj falë mundësive për edukim në vazhdim, trajnimeve dhe masterit.

Rasti #3. Punonjës social në OJQ – pjesërisht e arsimuar për punë sociale

Në historinë e rastit të paraqitur më poshtë, një punonjëse sociale në Tiranë (e arsimuar pjesërisht për punë sociale – vetëm nivelin master) na shpjegon sesi ka menaxhuar së fundmi një rast të mbrojtjes së fëmijës dhe sesi proceset vendimmarrëse lidhen me edukimin e saj fillestar dhe atë në vazhdim.

Duke i treguar intervistuesit për një rast se kishte menaxhuar së fundmi, ajo ndau historinë e një familjeje me dy fëmijë të cilëve ju referohet si “rast që njihet mirë nga shërbimet sociale”. Rasti ju referua OJQ-së së saj nga NJMF e asaj zone të Tiranës ku ishte e vendosur kjo familje në një strehëzë me kushte të këqija. Ajo kujton se fillimisht rastin ju prezantua “si problematik dhe që qarkullonte”. Nga prezantimi e kuptoi se duhet të priste një rast shumë të komplikuar. Megjithatë, duke qenë e qartë për detyrat dhe përgjegjësitë e saj vendosi se gjëja e parë që duhet të bënte ishte një vlerësim paraprak i rastit për të parë nëse fëmija/ët ishin në rrezik dhe a duhej ndërhyrje. “Rasti ishte i njohur, por duhej të bëja vlerësimin fillestar siç kërkon protokollin për mbrojtjen e fëmijëve”. Nga vlerësimi paraprak doli se fëmijët në këtë rast specifik ishin në rrezik dhe të neglizhuar. Ajo përmbledh shkurtimisht rastin si kjo histori: “Babai është një 78 vjeçar me probleme të shëndetit mendor, punon shumë që të nxjerr fare pak për familjen me katër vetë; gruaja, shumë më e re se ai, por edhe ajo me probleme të shëndetit mendor dhe dy vajza që janë 8 dhe 2 vjeçe.

Për shkak të gjendjes ekonomike dhe statusit shëndetësor të prindërve, fëmijët neglizhohen dhe abuzohen nga prindërit dhe të huajt”.

Na shpjegon se rasti kishte dhe një histori tjetër para se të raportohej, dhe nuk ishte zgjidhur me sukses. Para se të vinte tek organizata, rasti ishte adresuar dhe ofruar strehim tek një qendër për gratë e dhunuara. Arsyeja ishte se mamaja ishte përdhunuar në grup nga 10 adoleshentë në lagje. Pas përdhunimit, kishte kaluar stresin post-traumatik dhe kishte zhvilluar probleme mendore gjë që çoi edhe në neglizhim dhe abuzim të vajzave të saj. Për shkak të këtij neglizhimi dhe problemeve të shëndetit mendor të prindërve, vajza e madhe ishte viktimë e abuzimit seksual nga të huajt. “Këtë informacion e zbulova gjatë procesit të vlerësimit. Punonjësja sociale që e kishte ndeshur këtë rast dhe që na e referoi, e kishte intervistuar vajzën më të madhe. Gjatë intervistës kishte treguar se ishte ngacmuar seksualisht nga një i huaj, rreth 60 vjeç. I ishte afruar dhe i kishte thënë që t'i prekte vendet private në shkëmbim të ushqimit”.

Kur e pyesim si e menaxhoi rastin, ajo rendit hapat që kishte marrë ajo ose profesionistët e tjerë të përfshirë me rastin.

“Fillimisht, ju kërkua punonjësit social të një organizate në zonën ku jeton familja që të bënte një vizitë në familje për të konfirmuar faktin e neglizhimit dhe abuzimit nga prindërit. Më pas, punonjësi social dhe eprori i saj/tij e diskutuan dhe më thirrën mua për të konsultuar vendimin. Si ata, si unë (në emër të organizatës) vendosëm ta referonim rastin prapë tek NJMF-

ja e zonës, se vetëm NJMF-ja mund të thërrasë grupin multi-disiplinar për të adresuar plotësisht rastin. Në fakt, vlerësimi i parë dhe vizita ishin për të asistuar punonjësin social të NJMF-së. Ajo kërkoi ndihmën tonë për të vlerësuar rastin se i kishte kapacitetet e kufizuara; ajo është ekonomiste nëse nuk e kam gabim.”

Punonjësja sociale e NJM-së pak kohë kishte në këtë detyrë, se pozicioni i mëparshëm ishte shkurtuar për shkak të ristrukturimit. Ajo pranoi se fëmijët ishin në rrezik të lartë dhe të njëjtën ditë mori vendimin për të thirrur grupin multi-disiplinar. “Tek grupi-multidisiplinar ku morëm pjesë të gjithë, u diskutuan edhe njëherë të gjitha nga e para që të informohej pjesa tjetër e grupit dhe që të veprojnë të gjitha institucionet përkatëse.”

Kur reflekton për arsimimin dhe trajnimet ajo bën më shumë lidhje midis njohurive dhe aftësive që ka marrë nga trajnimet ku ka marrë pjesë mbi abuzimin seksual të fëmijëve dhe intervistimin. “Vlerësimi i rastit, analiza dhe procesi i vendim-marrjes u mbështetën tek ato që kam mësuar në trajnime dhe në praktikën time të punës më shumë se 8 vjeçare. Kështu kam mësuar të gjitha hapat e nevojshëm që duhen marrë për të adresuar rastin. Veç kësaj, kam marrë pjesë në një trajnim për intervistimin, organizuar nga FBI, i cili më ndihmoi shumë për aftësitë për intervistim, ndërhyrjet miqësore për fëmijën, interesin më të lartë të fëmijës, qasjen pjesëmarrëse dhe vendim marrjen në grup.”

Ajo përfundon duke thënë se pjesa tjetër (nënkupton procedurat) janë të lehta “vetëm ndiq protokollin”.



Aftësitë, njohuritë dhe interesat gjatë praktikës së mbrojtjes së fëmijëve

Në Shqipëri, fëmijët nuk janë parë si një kategori më vete e shërbimit social për vite të tëra. Sistemi i përkrahjes sociale pas komunizmit në Shqipëri, ishte mbështetur tek një model i cili kishte si referencë kryesore familjen dhe jo individin (Tomes, 1997). Falë advokacisë së Organizatave të fëmijëve në vend, vëmendja ka ardhur në rritje, gjë që me gjasë do të sjellë edhe më shumë interes për arsimimin mbi çështjet e fëmijëve. Veç kësaj, arsimimi më i specializuar, sidomos studimet master, janë bërë të detyrueshme për kontekstin shqiptar pas procesit të Bolonjës. Tregu i punës kërkon për çdo profesion, përfshirë punën sociale, përfundimin e studimeve 3+2 sipas skemës së Bolonjës. Kjo ka sjellë rritje të kërkesave për studime dhe kualifikime të tjera. Pavarësisht mundësive në rritje dhe aksesit tek kualifikime të tjera, praktika e konsoliduar, përvoja dhe ekspertiza për mbrojtjen e fëmijëve duhet të vazhdojë të përmirësohet më tej dhe të akumulohet që t'i shërbejë siç duhet kërkesave për mbrojtjen e fëmijëve si në njohuri dhe në praktikë. Përmes një ushtrimi për ndërtimin e konsensusit përgjatë fokus-grupeve të këtij studimi, janë identifikuar dhe renditur sipas një priorizimi konsensual një listë nevojash dhe interesash për ndërtim të mëtejshëm të kapaciteteve.

Këto përparësi mund të shërbejnë për të përmirësuar kurrikulat në universitete, të konsolidohen kurset e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të udhëheqin nismat e ardhshme për edukimin në vazhdim në këtë fushë. Megjithatë, një shqetësim i përgjithshëm lidhur me këto përparësi ishte se ato duhet të adresohen me kujdes, duke mbajtur parasysh se çdo program duhet të përgatitet duke bërë një vlerësim paraprak të nevojave që lidhen me përfituesit e synuar të këtij aktiviteti.

“Kemi bërë trajnime pafund, por ka munguar një planifikim i mirë për të lidhur ofertën me nevojën. Shpresoj që kjo të ndryshojë në të ardhmen. Nuk dua që çdo trajnim të fillojë nga e para me përkufizimet dhe llojet e dhunës. Kam nevoja të tjera, por asnjë nuk më ka pyetur para se të bëjë programin. Plani arsimor duhet të përshtatet me zhvillimin e karrierës” (Punonjës social i NJMF-së, Tiranë)

Lista nevojave prioritare për trajnim:

1. Shprehitë e përgjithshme të punës sociale dhe ato të punës me fëmijët në veçanti.
2. Njohuri të thella për politikën për mbrojtjen e fëmijëve dhe kuadrin ligjor.
3. Metodën kërkimore (aftësimi për përgatitjen dhe kryerjen e kërkimit)
4. Metodën e vlerësimit
5. Aftësi organizative dhe menaxheriale
6. Supervizimi në punë sociale dhe mekanizmat kundër konsumimit profesional.
7. Shprehitë për të punuar në skuadër dhe me grupet multi-disiplinare.
8. Përdorimi i teknologjisë për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.
9. Advokacia
10. Zgjidhja e konflikteve dhe aftësitë për negociim

Pjesëmarrësve ju kërkua të ndanin mendimet e tyre mbi mënyrat e të mësuarit që konsideronin më efikente dhe produktive për ta. Ju kushtua vëmendje e veçantë për të eksploruar qëndrimin e tyre për përdorimin e teknologjisë dhe të mësuarit online. Doli se shumica e të intervistuarve ishin tradicional, preferonin të mësonin në klasë, me metoda që ishin më popullore dhe më miqësore për ta. Edhe pse teknologjia përdoret gjerësisht nga të rinjtë (sidomos studentët), shumica e tyre ishte të familjarizuar vetëm me mediet sociale si *Facebook* dhe *Instagram* dhe e kishin të vështirë të imagjinonin proceset mësimore online.

Shpenzimet e studimeve të studentëve në Shqipëri vazhdojnë të mbulohen nga prindërit. Studentët e masterit shpesh punojnë për të plotësuar shpenzimet financiare që ju mbulon familja. Megjithatë, të dyja kategoritë nuk ishin të sigurta për të mbështetur idenë e pagesës së kurseve online. Gatishmëria ishte e ulët edhe tek praktikantët. Sipas tyre,

mësimet, certifikatat dhe diplomat e mara online nuk kanë reputacion shumë të mirë. Nëse paguhet programi, ata presin që ai të zhvillohet ballë-përballë dhe intensivisht,, kriteret të cilat besojnë se nuk përmbushen nga kurset mësimore online.

V. KONKLuzionet

Studimi parshtrori një panoramë të përgjithshme të praktikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe aftësimin të punënjësve social, përfshi njohuritë dhe interesat për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Kapitulli i fundit nxjerr përfundimet dhe jep rekomandime për tre probleme kryesore që u adresuan në këtë studim: shërbimet sociale dhe sistemi për mbrojtjen e fëmijëve në vend, stafi i shërbimeve sociale dhe çështjet që lidhen me arsimin për punë sociale dhe interesat dhe potencialet për zhvillimeve të ardhshme në këtë fushë.

Të dhënat e ndryshme që ka marrë në konsideratë ky studim pasqyrojnë disa pika të forta dhe sfida të shërbimit social, të mbrojtjes së fëmijëve dhe stafit përkatës. Ekzistenca e një sistemi social shtetëror dhe shërbimi për mbrojtjen e fëmijëve brenda tij, sektori i gjerë i shoqërisë civile dhe të qenit të hapur, ofrimi dhe fuqizimi i profesionit të punënjësve social në vend, si dhe shkollat e konsoliduara në vend, janë premisa të mira që shërbejnë si themel mbi të cilat mund të zhvillohet dhe konsolidohet më tej shërbimi për mbrojtjen e fëmijëve.

Krahas këtyre pikave të forta, janë identifikuar edhe probleme dhe sfida nga gjetjet e këtij studimi që janë paraqitur më poshtë dhe duke u pasuar nga rekomandime sesi të adresohen këto probleme dhe të kthehen në pika të forta për të bërë që shërbimi social të funksionojë më mirë, të ketë shërbime të mira për mbrojtjen e fëmijëve dhe një staf të kualifikuar.

• **Shërbimet sociale, mbrojtja e fëmijëve dhe stafi përkatës**

Mirëfunksionimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri sfidohet nga problemet e profesionalizmit, koordinimit të dobët midis aktorëve dhe burimeve të kufizuara dhe kapaciteteve për mbështetjen e stafit që ofron shërbimet përkatëse. Pavarësisht dispozitave ligjore, stafi i shërbimeve sociale, përfshirë shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve vazhdon të dominohet nga punonjës social jo-profesionistë në një kontekst ku nuk ka mungesa burimesh njerëzore në treg. Shpesh, kjo kombinohet me koordinimin dhe gatishmëri të dobët nga ana e aktorëve të tjerë që kanë detyrën statutores për të kontribuar tek menaxhimi i rasteve për mbrojtjen e fëmijëve. Kapacitetet e ngritura

brenda sistemit të shërbimeve sociale ose midis aktorëve të tjerë si dhe rrjetet e ngritura midis tyre janë të vështira për t'u mbajtur për shkak të ndryshimit të shpeshtë të stafit. Për ta zgjeruar listën e pengesave, problem për mirëfunksionimin e sistemit janë dhe burimet e kufizuara (njerëzore dhe infrastrukturore) dhe incentivat e dobëta (përfshirë ato financiare) të stafit ekzistues.

Rekomandime:

Për adresimin e këtyre sfidave, puna duhet të fillojë duke respektuar dhe zbatuar kuadrin ligjor përkatës. Duhet të zhvillohen mekanizma të rinj për të garantuar se sistemi punëson stafin e duhur dhe të kualifikuar si dhe i fuqizon për të koordinuar në mënyrë efektive me aktorët e tjerë përkatës.

Nga ana tjetër, kuadri ligjor duhet të pasurohet me specifikime të përgjegjësive dhe detyrave të aktorëve, sidomos të atyre që ju kërkohet të marrin pjesë dhe të kontribuojnë tek grupi i punës multi-disiplinar për menaxhimin e rastit për mbrojtjen e fëmijëve.

Së fundmi, edhe pasi të jetë parashikuar gjithçka me kuadrin ligjor dhe mekanizmat, nuk mund të presësh shumë për shkak të mungesës së burimeve dhe incentivave. Stafi i shërbimeve sociale, përfshirë punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme dhe burimet si dhe të motivohen dhe inkurajohen në punë me paga të përshtatshme, kontrata afatgjata si dhe nxitje të tjera financiare dhe jo financiare që deri tani mungojnë.

• **Arsimimi në punës sociale dhe nevojat e forcës së punës.**

Arsimimi për punën sociale është rritur me shpejtësi në Shqipëri tek tri shkollat e punës sociale në nivel universitar dhe ofron të tria nivelet e studimit. Gjatë këtij procesi në rritje kanë dalë edhe shumë probleme dhe sfida. Sidomos për praktikën e punës sociale dhe problemet për mbrojtjen e fëmijëve ka shumë dobësi të cilat i reflekton arsimimi për punën sociale kur vihet në praktikë. Në përgjithësi, ka në lidhje të dobët midis nivelit akademik dhe punës sociale në praktikë dhe nuk ka shumë shkëmbime midis stafit akademik dhe specialistëve të praktikës për të plotësuar kurrikulën me shembuj e raste që janë të përshtatshme për

kontekstin. Nga ana tjetër, njohuritë dhe aftësitë për mbikëqyrjen e punës sociale janë të varfra dhe ende nuk është prezantuar mbikëqyrja profesionale tek praktika e punës sociale. Së fundi, praktika gjatë kohës së studimeve është e kufizuar në kohë dhe shumëllojshmëri, për grupet e synuara dhe aftësimin ndaj të cilit ekspozohen studentët.

Rekomandime:

Kapacitetet njerëzore të arsimimit të punës sociale dhe praktikantët e punës sociale duhet të rrisin shkëmbimin e njohurive dhe aftësive nëpërmjet projekteve të përbashkëta kërkimore, përgatitjes së kurrikulës dhe leksioneve si dhe aktivitetet për vënien në praktikë të punës sociale.

Kryerja e praktikës së punës sociale duhet të rishikohet me qëllim jo vetëm rritjen e saj, por edhe cilësinë e praktikës që duhet të bëjnë studentët. Kjo mund të përfshijë edhe rishikim të marrëdhënieve midis universitetit dhe institucioneve/agjencive që ofrojnë mundësi për praktikë, rishikim dhe qartësim të monitorimit, mbikëqyrje dhe vlerësim të praktikës dhe aftësive të përfituara si dhe një agjendë të përbashkët midis dy palëve për të identifikuar dhe planifikuar kryerjen e praktikës që të jetë në përputhje me nevojat dhe mundësitë e grupeve të interesit.

Supervizimi/Mbikëqyrja profesionale e punës sociale duhet të bëhet pjesë edhe në praktikën shqiptare të punës sociale. Kjo do të ndikojë tek profesionalizmi i stafit ekzistues dhe do të krijojë më shumë mundësi punësimi dhe një mjedis më të hapur për praktikë cilësore të punës sociale për studentët e punës sociale.

• Interesat dhe potencialet për zhvillimet në të ardhmen

Të dhënat nga të gjitha burimet konfirmojnë interesa të forta dhe potenciale për konsolidimin dhe zhvillime të reja të shërbimeve sociale, shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe punës sociale në vend. Interesat dhe potencialet e identifikuar janë nënvizuar tek seksioni i fundit si rekomandim që duhet ta përmbushin aktorët përkatës.

Rekomandime:

Marrëdhënia midis mundësive për zhvillim karriere të stafit dhe ngritjes së kapaciteteve duhet të fuqizohet në mënyrë që kapacitetet e ngritura nëpërmjet aktiviteve të vazhdueshme arsimore të mos jenë vetëm për vendin e punës dhe vënien në praktikë, por edhe të mbeten për një kohë të gjatë.

Nismat nga institucionet shtetërore, akademike dhe/ose OJQ për të identifikuar zhvillime dhe për të hartuar projekte për të ngritur më shumë kapacitetet për stafin e shërbimeve sociale për të koordinuar më mirë dhe për të shmangur përsëritjet ose mbivendosjet si dhe të garantohet mundësi e barabartë për pjesëmarrësit nga i gjithë vendi. Me këtë qëllim, një bazë të dhënash me informacione për arsimimin dhe edukimin në vazhdim të stafit do të ndihmonte për të pasur dijeni dhe për të ndihmuar për planifikime të ardhshme në këtë fushë. Fushat e interesit që janë identifikuar dhe që kanë përparësi janë renditur tek gjetjet e këtij studimi dhe mund të shërbejnë si një bazë e mirë për të udhëhequr procesin e planifikimit në këtë drejtim.

E fundit, por jo për nga rëndësia, preferencat mësimore dhe mundësitë e stafit duhet të merren në konsideratë kur përgatiten dhe zbatohen aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve. Metodot inovative kanë nevojë për punë përgatitore që të kuptohet, pranohet dhe të përdoret në mënyrë efçente nga përfituesit. Duke pasur parasysh pamundësitë financiare të studentëve dhe profesionistëve të punës sociale, kostoja për edukimin në vazhdim duhet të jetë e ulët që të ketë më shumë akses dhe mundësi të barabarta. Vizitat për shkëmbime përvojash, grupe pune dhe rastet konkrete janë ndër mjetet mësimore më të vlerësuara për studentët dhe praktikantët e punës sociale.

VI. REFERENCA

- BKTf (2011) *Analiza e situatës së sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri*, Shqipëria, <http://resourcecentre.savethechildren.se/sites/default/files/documents/6423.pdf>
- Cabiri, Y. et al.) Raporti mbi Zhvillimin e Njerëzve, *Albania 2015*, UNDP Shqipëri.
- Canavera, M., Akesson, B., dhe D. Landis. (2014), *Trajnim për stafin e Shërbimit Social për Rajonin Perëndimor dhe Qendror të Afrikës 27* Nëntor, 2014, UNICEF.
- Qendra Fëmijët Sot Tirana (2013) *Analiza Institucionale e Rolit, detyrave dhe përgjegjësi të Shërbimit Social Shtetëror në kuadër të Reformës së Shërbimeve të Kujdesit Social*, Qendra Fëmijët Sot Tiranë, Qershor 2013
- Departamenti i Punës Sociale, UT (2009) *Zbatimi i standardeve të Bolonjës në fushën e Shkencave Sociale dhe të Edukimit Shqipëri*
- Dauti, M. & Bejko E. (2015) Përdorimi Provave Shkencore gjatë hartimit të Politikave të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2014/10/RRPP_Policy-Dokument-no1-Albania.pdf
- Dhembo E. (2014) *Modeli Social Evropian i Shqiptarëve: Administrata Publike në Shqipëri midis qytetarëve dhe politikës*; FES dhe IDM Shqipëri.
- Komisioni Evropian (2013) Raporti Progresit për Shqipërinë 2013; *Dokument shoqëruar Komunikata e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin; Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 13-2014* http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013.pdf
- Hoxha, A. (2011) *Një vëzhgim historik mbi zhvillimin e filantropisë në Shqipëri*, Partners Shqipëri, Tirana. http://www.partnersalbania.org/Nje_Veshtrim_Historik_Zhvillimin_filantropise.pdf
- Haxhiymeri, E. & Dhembo, E. (2010). *Ulja e Papunësisë tek të Rinjtë nëpërmjet ngritjes së urave midis Universiteteve dhe Tregut të Punës*, COPORE: KOMPETENCAT PËR ULJEN E VARFËRISË, 2010 VITI EVROPËS PËR LUFTËN NDAJ VARFËRISË DHE PËRJASHTIMIT SOCIAL. Publikuar nga ENOTHE P-A Hogeschool Van Amsterdam, NL. dhjetor 2010, pp. 121-127. http://www.enothe.eu/cop/final_programme_copore-conference_april2010.pdf
- Gedeshi, I. & Jorgoni, E. (2012) *Ndikimi social tek emigrimi dhe migrimi rural-urban në Evropën Qendrore dhe Lindore, Raporti Përfundimtar për Vendin, Shqipëri prill 2012*
- Maestral (2015) *Mapping and Analysis of the Albanian CP System*, TdH Albania.
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, *Strategjia ndërsektoriale për përfshirjen sociale 2007-2013*
- Ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore (2014) *Strategjia Kombëtare Ndersektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020*, Tiranë Albania. http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/15-01-13-05-51-29DRAFT_STRATEGJIA_DECENTRALIZIMIT.pdf
- MMSR. (2015) *National Report on Child Rights Situation in Albania 2013-2014* (Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013-2014), MMSR 2015
- MMSR. (2015b). *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (Dokument Draft)*
- Qendra Kombëtare për Studimet Sociale. (2013). *Shërbimet e Kujdesit Social në Shqipëri; Harta e përditësuar, karakteristikat dhe tendencat*
- Save the Children (2012) *Situata për Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri*, Tiranë Shqipëri <https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Child%20Rights%20Situation%20Analysis%20Albania%5B1%5D.pdf>

- ShSSH & UNICEF (2014) "Konventa për reformimin e Shërbimeve Sociale Shtetërore", Tiranë, Shqipëri.
 - Tahsini, I., Lopari, E., Lasku, A. & Voko, K. (2013) *Reforma e Shërbimeve të Përkrahjes Sociale në Shqipëri, Vlerësimi Kapaciteteve të ofruesve të Shërbimit Social për modelin e menaxhimit të rastit në fushën e shërbimeve sociale*, TdH Shqipëri
 - Tahsini, I., Duci, V., & Ajdini, J. (2009) PËRAFRIMI I KURRIKULAVE: RASTI I DEGËS SË PUNËS SOCIALE) për Zbatimin e Standardeve të Bolonjës në fushën e Shkencave dhe Edukimit Social në Shqipëri, Tiranë, Shqipëri.
 - Tomes I., (1997) E drejta për sigurime sociale, Tiranë, Shqipëri
 - UNICEF Shqipëri, *Situata e Fëmijëve*, nxjerrë nga <http://www.unicef.org/albania/children.html> Sep. 2015
 - Voko, K. & Tahsini, I. (2014) *Fëmijët në lëvizje në Shqipëri, Përgjigja e Sistemit për Mbrojtjen e Fëmijëve ndaj Nevojave të Tyre, Analiza e Situatës*, Save the Children & TdH Shqipëri, [https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/MARIO%20SITAN%20REPORT%20\(eng\)_1.pdf](https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/MARIO%20SITAN%20REPORT%20(eng)_1.pdf)
 - Shifrat Demografike të Bankës Botërore në Shqipëri, të nxjerra nga <http://data.worldbank.org/country/albania> dhe <http://databank.worldbank.org/data//reports.aspx?source=2&country=ALB&series=&period> Sep. 2015
 - World Vision (2013) *Studim Vlerësimi për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve*, World Vision Shqipëri
- Dokumente ligjorë**
- Ligji Nr. 163/2014 "PËR URDHRIN E PUNONJËSVE SOCIALË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" http://www.parlament.al/ëeb/pub/ligj_nr_163_dt_4_12_2014_20659_1.pdf
 - Ligj Nr. 86/2013, datë 14.02.2013 "Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës "Për Procedurën e Komunikimit"
 - Ligj Nr. 104/2012 datë 19.11.2012, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"
 - VKM Nr. 512, datë 31.05.2006.
 - Ligj Nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për Përkrahjen dhe shërbimet sociale".
 - Udhëzim 1321/10, datë 3.12.2003 "Për licencimin e personave juridik privatë, përfshirë OJQ-të, për ofrimin e shërbimeve të Kujdesit Sociale"
 - Ligj Nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat shtetërore"
 - Ligj Nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave publike tek njësitë e qeverisjes vendore"
 - Ligj Nr. 7710, datë 18.5.1993, "Për asistencën dhe përkrahjen sociale".
 - Ligj Nr. 7491, datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

VII. SHTOJCA

1. Formulari për miratimin e informuar

Miratimi i informuar

Prezantimi dhe qëllimi i studimit

Emri im është [emri]. Punoj për Platformën për Mbrojtjen e Fëmijëve (ëëë.childhub.org), një nismë rajonale midis shumë partnerësh për të mbështetur profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve në Evropën Juglindore. Jam pjesë e ekipit që identifikon nevojat e personelit për mbrojtjen e fëmijëve në tetë shtete të Evropës Juglindore: Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Moldavi, Rumani dhe Serbi. Studimi mbështetet nga BE-ja, Fondacioni Oak dhe Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim. Kërkimi do të na ndihmojë me informacion të vlefshëm në kuadrin e përgjithshëm të profesionistëve, para-profesionistëve dhe praktikës për mbrojtjen e fëmijëve në komunitet, si dhe për aftësitë e stafit për mbrojtjen e fëmijëve, njohuritë dhe interesat për të fuqizuar stafin për mbrojtjen e fëmijëve dhe për përmirësimin e përgjithshëm të mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve.

Përfitimet materiale

Gjetjet e këtij studimi do të shërbejnë direkt për strategjinë e përgjithshme të Platformës për Mbrojtjen e Fëmijëve për të mbështetur fuqizimin e sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve në rajon. Nuk ka përfitime të drejtëpërdrejta për individët që marrin pjesë në kërkim.

Llojet e pyetjeve

Do ju bëj disa pyetje për praktikën e mbrojtjes së fëmijëve (në vend), specifikisht për mënyrën sesi janë trajnuar dhe si vazhdojnë të mësojnë gjatë praktikës individët që bëjnë mbrojtjen e fëmijëve.

Heqja e disa pyetjeve ose përfundimi i pjesëmarrjes

Mund të vendosni të mos merrni pjesë në intervistë, ose mund të më thoni se nuk preferoni t'i përgjigjeni një pyetje të caktuar dhe unë do ta le atë pyetje. Nuk është e nevojshme t'i përgjigjeni pyetjeve që ju venë në siklet. Nëse doni, mund ta përfundojmë në çdo moment intervistën dhe kjo nuk do të ndikojë tek marrëdhënia juaj me Platformën për Mbrojtjen e Fëmijëve ose donatorët e projektit.

Konfidencialiteti

Të gjitha përgjigjet do të mbeten private dhe konfidenciale. Të vetmit persona që do të kenë akses tek ky informacion janë kërkuesit e studimit. Kur të hedhim rezultatet e studimit, nuk do ta lidhim emrin tuaj me asnjë nga gjërat që thatë.

Kontakti

Nëse keni pyetje për kërkimin ose nëse dalin probleme, mund të kontaktoni: *[ju lutem vendosni emrin dhe të dhënat tuaja (telefon, e-mail) për secilin nga përfaqësuesit e vendit]*

A doni të merrni pjesë në këtë studim? **Po / Jo**

Nëse **jo**, shpjegoni pse: _____

Nëse **po**, intervistuesi duhet të nënshkruajë më poshtë dhe të vazhdojë më intervistën.

Konfirmoj se ja kam dhënë gjithë informacionin e mësipërm pjesëmarrësit dhe ai/ajo ka rënë dakord të marrë pjesë.

Nënshkrimi kërkuesit: _____

Data: _____

2. Udhëzues gjysmë i strukturuar për intervistën

Udhëzues i intervistës individuale gjysmë të strukturuar: Akademikët & Menaxherët

Miratimi i informuar

Formulari për dhënien e miratimit të informuar (faqe 5-6), më pas vazhdoni me intervistën.

Prezantimi

Faleminderit që morët pjesë në kërkim. Jam shumë i/e interesuar të dëgjoj mendimin tuaj për stafin e shërbimeve sociale dhe si lidhet me mbrojtjen e fëmijëve (vendi).

Demografia

Rishikoni pyetjet që lidhen me demografinë (faqa 7) më pas vazhdoni.

Të përgjithshme

Çfarë mendon publiku i gjerë për punën sociale (në vend)? Çfarë mendon shoqëria civile për punën sociale (në vend)? Çfarë mendojnë përfituesit për punën sociale (në vend)?

Më tregoni si e kuptoni ju mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Kush e bën mbrojtjen e fëmijëve (në vend)?

- Cilat janë emërtimet zyrtare dhe rolet e praktikantëve të ndryshëm për mbrojtjen e fëmijëve (p.sh. punonjësit e shërbimeve sociale, punonjësit social, para-profesionistët, punonjësit në komunitet, etj.)?
- Tek cilat agjenci punojnë (p.sh. OJQ-të, agjencitë qeveritare, etj.)?
- Në cilat zona/qarqe punojnë (të vendit) (p.sh. a shërbehen më mirë disa zona sesa të tjerat)?
- Sa trajnohen çdo vit? Nëse është e mundur, ju lutem jepni shifrat sa janë trajnuar çdo vit për pesë vitet e fundit.

Kurrikula

Si trajnohen individët që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (zyrtarisht dhe jo-zyrtarisht)?

- Çfarë trajnimi kanë bërë para se të fillojnë punën në këtë profesion (p.sh., të diplomuar, trajnim akademik si a BSW/MSW, trajnim OBF/OJQ, etj.)? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?
- Çfarë edukimi kanë marrë gjatë detyrës/në vazhdimësi pasi kanë përfunduar trajnimin e tyre fillestar? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?

Kërkimi

A mendoni se janë të rëndësishme njohuritë bazë mbi metodat kërkimore (studime bazë, vlerësime programi) për praktikantët e mbrojtjes së fëmijëve (në vend)?

- Nëse po, a mendoni se individët që punojnë me mbrojtjen e fëmijëve e kanë njohurinë bazë mbi metodat kërkimore për të qenë në gjendje të kryejnë kërkimet e tyre mbi çështjet dhe programet e fëmijëve? Ju lutem, shpjegojeni.

A është kërkimi, si studimet kërkimore dhe botime të tjera kërkimore mbi çështjet e fëmijëve, i integruar tek programet edukuese të trajnimit fillestar dhe/ose në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, shpjegoni pse.
- Nëse jo, shpjegoni pse jo.

Politikat

Si mësojnë për politikën dhe legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve individët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve?

Çfarë politikash/ligjesh janë përfshirë tek programi trajnimit?

A i përgatisin programet e trajnimit individët që të angazhohen dhe/ose ndikojnë tek politikat/legjislacioni para se të fillojnë punën në profesion dhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, na jepni në shembull.

Praktika

Çfarë aftësish dhe kompetencash thelbësore praktike në fushën e mbrojtjes së fëmijëve janë identifikuar tek programet dhe kurrikulat ekzistuese të trajnimit?

A është integruar tek programet e trajnimit praktika për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet stazhit ose praktikës, si në fillim të profesionit edhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, ju lutem përshkruani ku bëhen këto aktivitete (p.sh. brenda vendit (kufijve) dhe si janë të strukturuar.

Shpjegoni si programet aktuale të trajnimit janë ose nuk janë të dobishëm dhe/ose të zbatueshëm në punën e përditshme të individëve që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Kur përfundojnë trajnimin, si angazhohen këta individë për mbrojtjen e fëmijëve për të pasur gjithmonë njohuri të përditësuar?

Përfundimi

A ka ndonjë gjë që dëshironi të shtoni për të cilën nuk kemi folur sot?

A ke ndonjë pyetje për mua?

Udhëzues i intervistës individuale gjysmë të strukturua: Praktikantët

Miratimi i informuar

Formulari për dhënien e miratimit të informuar (faqe 5-6), më pas vazhdoni me intervistën.

Prezantimi

Faleminderit që morët pjesë në kërkim. Jam shumë i/e interesuar të dëgjoj mendimin tuaj për stafin e shërbimeve sociale dhe si lidhet me mbrojtjen e fëmijëve (vendi).

Demografia

Rishikoni pyetjet që lidhen me demografinë (faqe 7) më pas vazhdoni.

Të përgjithshme

Çfarë mendon publiku i gjerë për punën sociale (në vend)? Çfarë mendojnë përfituesit për punën sociale (në vend)?

Më tregoni si e kuptoni ju mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Kush e bën mbrojtjen e fëmijëve (në vend)?

- Cilat janë emërtimet zyrtare dhe rolet e praktikantëve të ndryshëm për mbrojtjen e fëmijëve (p.sh. punonjësit e shërbimeve sociale, punonjësit social, para-profesionistët, punonjësit në komunitet, etj.)?
- Tek cilat agjenci punojnë (p.sh. OJQ-të, agjencitë qeveritare, etj.)?
- Në cilat zona/qarqe punojnë (të vendit) (p.sh. a shërbehen më mirë disa zona sesa të tjerat)?

Kurrikula

Si trajnohen individët që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (zyrtarisht dhe jo-zyrtarisht)?

- Çfarë trajnimi kanë bërë para se të fillojnë punën në këtë profesion (p.sh., të diplomuar, trajnim akademik si a BSË/MSË, trajnim OBF/OJQ, etj.)? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?
- Çfarë edukimi kanë marrë gjatë detyrës/në vazhdimësi pasi kanë përfunduar trajnimin e tyre fillestar? Ju lutem, përshkruani këto programe

(p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?

Kërkimi

A mendoni se janë të rëndësishme njohuritë bazë mbi metodat kërkimore (studime bazë, vlerësime programi) për praktikantët e mbrojtjes së fëmijëve (në vend)?

- Nëse po, a mendoni se individët që punojnë me mbrojtjen e fëmijëve e kanë njohurinë bazë mbi metodat kërkimore për të qenë në gjendje të kryejnë kërkimet e tyre mbi çështjet dhe programet e fëmijëve? Ju lutem, shpjegojeni.

A është kërkimi, si studimet kërkimore dhe botime të tjera kërkimore mbi çështjet e fëmijëve, i integruar tek programet edukuese të trajnimit fillestar dhe/ose në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, shpjegoni pse.
- Nëse jo, shpjegoni pse jo.

Politikat

Si mësojnë për politikat dhe legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve individët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve?

Çfarë politikash/ligjesh janë përfshirë tek programi trajnimit?

A i përgatisin programet e trajnimit individët që të angazhohen dhe/ose ndikojnë tek politikat/legjislacioni para se të fillojnë punën në profesion dhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, na jepni në shembull.

Trajnimi që ke kryer para se të filloje punën profesionale dhe edukimi në detyrë/vazhdimësi a të ka përgatitur për të zbatuar dhe/ose ndikuar tek politika/legjislacioni?

- Nëse po, na jep një shembull.

Praktika

Çfarë aftësish dhe kompetencash thelbësore praktike në fushën e mbrojtjes së fëmijëve janë identifikuar tek programet dhe kurrikulat ekzistuese të trajnimit?

A është integruar tek programet e trajnimit praktika për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet stazhit ose praktikës, si në fillim të profesionit edhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, ju lutem përshkruani ku bëhen këto aktivitete (p.sh. brenda vendit (kufijve) dhe si janë të strukturuar.

Shpjegoni si programet aktuale të trajnimit janë ose nuk janë të dobishëm dhe/ose të zbatueshëm në punën e përditshme të individëve që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Kur përfundojnë trajnimin, si angazhohen këta individë për mbrojtjen e fëmijëve për të pasur gjithmonë njohuri të përditësuar?

Përfundimi

A ka ndonjë gjë që dëshironi të shtoni për të cilën nuk kemi folur sot?

A ke ndonjë pyetje për mua?

Udhëzues Interviste për Histori Rasti: Praktikantët

(Përshtatur nga Child Frontiers (Kufijtë e Fëmijëve), 2010)

Rasti

Pa përmendur emra, ju lutem përshkruani hap pas hapi një rast për mbrojtjen e fëmijëve që keni menaxhuar.

Në këtë pikë, kërkuesi duhet të krijojë bashkë më praktikantit hap pas hapi një plan për procesin e menaxhimit të rastit.

Për secilin nga hapat e procesit të menaxhimit të rastit, bëni pyetjen më poshtë:

- Kush vendosi se duhej ndërmarrë ky veprim? A kishte opsione të tjera? Nëse po, pse u zgjodh pikërisht ky opsion?
- A kujtoni ndonjë pjesë të trajnimit, si para të fillonit detyrën tuaj ose gjatë detyrës/edukimit të vazhdueshëm që ju përgatiti të merrni këtë vendim?
- A mendoni se fëmija dhe/ose familja ishte e kënaqur ose e pakënaqur me masat që u ndërmorën në këtë pikë? Nëse po, nga e dini?
- *Sigurohuni që praktikanti të përfshijë detajet e mëposhtme:*
- *Si dëgjoi praktikanti për fëmijën dhe/ose familjen;*
- *Personat ose shërbimet të cilave praktikanti ju referoi fëmijën dhe/ose familjen;*
- *Ku është fëmija sot dhe është apo jo ende në kontakt personi.*

Kur praktikanti të ketë përfunduar historinë; përsëritjani edhe njëherë për t'u siguruar që nuk ju ka shpëtuar asnjë detaj dhe se kuptuar të gjitha hapat.

Pyetjet përmbyllëse

A dëshironi të shtoni gjë tjetër?

A keni pyetje për mua?

3. Udhëzues për diskutime në fokus-grupe

Udhëzues për diskutim në fokus-grup me: Edukatorët

Miratimi i informuar

Formulari për dhënien e miratimit të informuar (faqe 5-6), më pas vazhdoni me intervistën.

Prezantimi

Faleminderit që morët pjesë në kërkim. Jam shumë i/e interesuar të dëgjoj mendimin tuaj për stafin e shërbimeve sociale dhe si lidhet me mbrojtjen e fëmijëve (vendi).

Demografia

Rishikoni pyetjet që lidhen me demografinë (faqja 7) më pas vazhdoni.

Të përgjithshme

Çfarë mendon publiku i gjerë për punën sociale (në vend)? Çfarë mendojnë përfituesit për punën sociale (në vend)?

Më tregoni si e kuptoni ju mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Kush e bën mbrojtjen e fëmijëve (në vend)?

- Cilat janë emërtimet zyrtare dhe rolet e praktikantëve të ndryshëm për mbrojtjen e fëmijëve (p.sh. punonjësit e shërbimeve sociale, punonjësit social, para-profesionistët, punonjësit në komunitet, etj.)?
- Tek cilat agjenci punojnë (p.sh. OJQ-të, agjencitë qeveritare, etj.)?
- Në cilat zona/qarqe punojnë (të vendit) (p.sh. a shërbehen më mirë disa zona sesa të tjerat)?
- Sa trajnohen çdo vit? Nëse është e mundur, ju lutem jepni shifrat sa janë trajnuar çdo vit për pesë vitet e fundit.

Kurrikula

Si trajnohen individët që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (zyrtarisht dhe jo-zyrtarisht)?

- Çfarë trajnimi kanë bërë para se të fillojnë punën në këtë profesion (p.sh., të diplomuar, trajnim akademik si a BSW/MSW, trajnim OBF/OJQ, etj.)? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?
- Çfarë edukimi kanë marrë gjatë detyrës/në vazhdimësi pasi kanë përfunduar trajnimin e tyre fillestar? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?

Cili është roli juaj tek proceset e trajnimit?

Kërkimi

A mendoni se janë të rëndësishme njohuritë bazë mbi metodat kërkimore (studime bazë, vlerësime programi) për praktikantët e mbrojtjes së fëmijëve (në vend)?

- Nëse po, a mendoni se individët që punojnë me mbrojtjen e fëmijëve e kanë njohurinë bazë mbi metodat kërkimore për të qenë në gjendje të kryejnë kërkimet e tyre mbi çështjet dhe programet e fëmijëve? Ju lutem, shpjegojeni.

A është kërkimi, si studimet kërkimore dhe botime të tjera kërkimore mbi çështjet e fëmijëve, i integruar tek programet edukuese të trajnimit fillestar dhe/ose në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, shpjegoni pse.
- Nëse jo, shpjegoni pse jo.

Politikat

Si mësojnë për politikat dhe legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve individët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve?

Çfarë politikash/ligjesh janë përfshirë tek programi trajnimit?

- Nëse po, na jepni në shembull.

A i përgatisin programet e trajnimit individët që të angazhohen dhe/ose ndikojnë tek politikat/legjislacioni para se të fillojnë punën në profesion dhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, na jepni në shembull.

Praktika

Bëni një ushtrim për arritjen e konsensusit (shikoni faqen 27)

Çfarë aftësish dhe kompetencash thelbësore praktike në fushën e mbrojtjes së fëmijëve janë identifikuar tek programet dhe kurrikulat ekzistuese të trajnimit?

A është integruar tek programet e trajnimit praktika për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet stazhit ose praktikës, si në fillim të profesionit edhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, ju lutem përshkruani ku bëhen këto aktivitete (p.sh. brenda vendit (kufijve) dhe si janë të strukturuar.

Shpjegoni si programet aktuale të trajnimit janë ose nuk janë të dobishëm dhe/ose të zbatueshëm në punën e përditshme të individëve që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Kur përfundojnë trajnimin, si angazhohen këta individë për mbrojtjen e fëmijëve për të pasur gjithmonë njohuri të përditësuara?

Përfundimi

A ka ndonjë gjë që dëshironi të shtoni për të cilën nuk kemi folur sot?

A ke ndonjë pyetje për mua?

Udhëzues për diskutimin në fokus-grup me: Praktikantët

Miratimi i informuar

Formulari për dhënien e miratimit të informuar (faqe 5-6), më pas vazhdoni me intervistën.

Prezantimi

Faleminderit që morët pjesë në kërkim. Jam shumë i/e interesuar të dëgjoj mendimin tuaj për stafin e shërbimeve sociale dhe si lidhet me mbrojtjen e fëmijëve (vendi).

Demografia

Rishikoni pyetjet që lidhen me demografinë (faqe 7) më pas vazhdoni.

Të përgjithshme

Çfarë mendon publiku i gjerë për punën sociale (në vend)? Çfarë mendojnë përfituesit për punën sociale (në vend)?

Më tregoni si e kuptoni ju mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Kush e bën mbrojtjen e fëmijëve (në vend)?

- Cilat janë emërtimet zyrtare dhe rolet e praktikantëve të ndryshëm për mbrojtjen e fëmijëve (p.sh. punonjësit e shërbimeve sociale, punonjësit social, para-profesionistët, punonjësit në komunitet, etj.)?
- Tek cilat agjenci punojnë (p.sh. OJQ-të, agjencitë qeveritare, etj.)?
- Në cilat zona/qarqe punojnë (të vendit) (p.sh. a shërbehen më mirë disa zona sesa të tjerat)?
- Sa trajnohen çdo vit? Nëse është e mundur, ju lutem jepni shifrat sa janë trajnuar çdo vit për pesë vitet e fundit.

Cilët janë aktorët e tjerë që bashkëpunojnë me ju në punën e përditshme? Si mendoni se ndikon kjo për punën tuaj?

Kurrikula

Si trajnohen individët që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (zyrtarisht dhe jo-zyrtarisht)?

- Çfarë trajnimi kanë bërë para se të fillojnë punën në këtë profesion (p.sh., të diplomuar, trajnim akademik si a BSW/MSW, trajnim OBF/OJQ, etj.)? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?
- Çfarë edukimi kanë marrë gjatë detyrës/në vazhdimësi pasi kanë përfunduar trajnimin e tyre fillestar? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi?

Kërkimi

A mendoni se janë të rëndësishme njohuritë bazë mbi metodat kërkimore (studime bazë, vlerësime programi) për praktikantët e mbrojtjes së fëmijëve (në vend)?

- Nëse po, a mendoni se individët që punojnë me mbrojtjen e fëmijëve e kanë njohurinë bazë mbi metodat kërkimore për të qenë në gjendje të kryejnë kërkimet e tyre mbi çështjet dhe programet e fëmijëve? Ju lutem, shpjegojeni.

A është kërkimi, si studimet kërkimore dhe botime të tjera kërkimore mbi çështjet e fëmijëve, i integruar tek programet edukuese të trajnimit fillestar dhe/ose në detyrë/në vazhdimësi?

- Ju lutem shpjegoni

Politikat

A përfshiheshin politikat dhe legjislacioni për mbrojtjen e fëmijës në trajnimin tuaj?

- Nëse po, Ju lutem na shpjegoni si keni mësuar për këto politika dhe ligje.

Çfarë politikash/ligjesh janë përfshirë tek programi trajnimit?

A i përgatisin programet e trajnimit individët që të angazhohen dhe/ose ndikojnë tek politikat/legjislacioni para se të fillojnë punën në profesion dhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, na jepni në shembull.

A ju përgatiti trajnimi para se të fillonit punën profesionale dhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi, për të zbatuar dhe/ose për të ndikuar tek politikat/legjislacioni?

- Nëse po, na jepni në shembull.

Praktika

Bëni një ushtrim për arritjen e konsensusit (shikoni faqen 27)

Çfarë aftësish dhe kompetencash thelbësore praktike në fushën e mbrojtjes së fëmijëve janë identifikuar tek programet dhe kurrikulat ekzistuese të trajnimit?

A është integruar tek programet e trajnimit praktika për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet stazhit ose praktikës, si në fillim të profesionit edhe gjatë edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, ju lutem përshkruani ku bëhen këto aktivitete (p.sh. brenda vendit (kufijve) dhe si janë të strukturuar.

Shpjegoni si programet aktuale të trajnimit janë ose nuk janë të dobishëm dhe/ose të zbatueshëm në punën e përditshme të individëve që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Ju lutem përshkruani se çfarë supervizimi ju bëhet në punën tuaj aktuale.

- A mendoni se ky supervizim është i mjaftueshëm për të qenë një punonjës efektiv?

Me të përfunduar trajnimit, a keni synim të përditësoni njohuritë tuaja nëpërmjet edukimit në detyrë/në vazhdimësi?

- Nëse po, si mendoni ta bëni këtë?
- Nëse jo, pse?

Përfundimi

- A ka ndonjë gjë që dëshironi të shtoni për të cilën nuk kemi folur sot?
- A ke ndonjë pyetje për mua?

Udhëzues për diskutimin në fokus-grup me: Studentët

Miratimi i informuar

Formulari për dhënien e miratimit të informuar (faqe 5-6), më pas vazhdoni me intervistën.

Prezantimi

Faleminderit që morët pjesë në kërkim. Jam shumë i/e interesuar të dëgjoj mendimin tuaj për stafin e shërbimeve sociale dhe si lidhet me mbrojtjen e fëmijëve (vendi).

Demografia

Rishikoni pyetjet që lidhen me demografinë (faqja 7) më pas vazhdoni.

Të përgjithshme

Çfarë mendon publiku i gjerë për punën sociale (në vend)? Çfarë mendojnë përfituesit për punën sociale (në vend)?

Më tregoni si e kuptoni mbrojtjen e fëmijëve (në vend)?

Ju lutem, përshkruani motivimin tuaj për të studiuar punë sociale (në vend).

Si i paguani studimet?

Çfarë pune do të dëshironit pasi të mbaroni studimet?

Kurrikula

A jeni trajnuar (formalisht dhe jo formalisht) për mbrojtjen e fëmijëve?

- Çfarë trajnimi merrni aktualisht ((p.sh., të diplomuar, trajnim akademik si a BSË/MSË, trajnim OBF/OJQ, etj.)?

- A keni dijeni për ndonjë program trajnimi në detyrë/edukimi në vazhdimësi tek të cilët mund të merrni pjesë pasi të keni përfunduar trajnimin fillestar? Ju lutem, përshkruani këto programe (p.sh. kush e jep trajnimin, programet dhe diplomat e dhëna, kohëzgjatja, etj.) Cilat janë pikat e forta dhe sfidat e këtyre programeve trajnimi? A mendoni se do të merrni pjesë tek këto trajnime kur të mbaroni trajnimin aktual? A shikoni ndonjë pengesë për të pasur akses tek këto trajnime në të ardhmen?

Kërkimi

A është kërkimi, qoftë studime kërkimore apo botime të tjera kërkimore mbi mbrojtjen e fëmijëve, i integruar tek programi aktual i trajnimit?

- Nëse po, na jepni shembull.

A mendoni se keni njohurinë bazë mbi metodat kërkimore (studime bazë, vlerësimi programit) për të kryer ju vetë kërkime mbi çështjet dhe programet për mbrojtjen e fëmijëve kur të jeni vetë praktikant i fushës?

- Nëse po, jepni një shembull.
- Nëse jo, diskutoni pse jo.

Politika

A janë të përfshira politikat për mbrojtjen e fëmijëve dhe legjislacioni tek trajnimi juaj?

- Nëse po, përshkruani si keni mësuar për këto politika për mbrojtjen e fëmijëve dhe legjislacionin. Çfarë politikash/legjislacionesh janë përfshirë tek programi trajnimit?

A mendoni se trajnimi po ju përgatit për t'u angazhuar me dhe/ose për të ndikuar tek politika/legjislacioni?

- Nëse po, diskutojeni.

A mendoni se trajnimi po ju përgatit të zbatoni dhe/ose ndikoni tek politikat/legjislacioni?

- Nëse po, diskutojeni.

Praktika

Bëni një ushtrim për arritjen e konsensusit (shikoni faqen 27)

Çfarë aftësish dhe kompetencash thelbësore praktike në fushën e mbrojtjes së fëmijëve janë përfshirë tek programi juaj i trajnimit?

A është përfshirë praktika për mbrojtjen e fëmijëve e integruar tek programi juaj i trajnimit nëpërmjet stazhit ose praktikës? Nëse po, këto aktivitete a bëhen brenda kufijve (të vendit) apo jashtë kufijve (të vendit)? A keni plan të merrni pjesë tek këto praktika ose stazhe?

A besoni se programi aktual i trajnimit është i dobishëm dhe/ose zbatueshëm në punën e përditshme të individëve që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (në vend).

Përfundime

A ka ndonjë gjë që dëshironi të shtoni për të cilën nuk kemi folur sot?

A keni ndonjë pyetje për mua?

4. Ushtrim për arritjen e konsensusit

Ushtrim për arritjen e konsensusit

Kërko nga pjesëmarrësit të rendisin përgjigjet e mundshme për këto pyetje: Cilat janë aftësitë, njohuritë dhe nevojat mësimore për stafin e shërbimeve sociale (në vend)?

Duke përdorur këto përgjigje, udhëzoje grupin që t'i vendosë, përshtasë, rishikojë dhe t'i konfirmojë sipas shtyllave. Sigurohuni që ta përsërisni procesin për vendosjen e tyre dhe të negocioni derisa të arrihet një konsensus midis pjesëtarëve të grupit.

Përdorni formën më poshtë për të vendosur përgjigjet.

Aftësitë kryesore, njohuritë dhe nevojat mësimore të identifikuara:

Lista e lirë:	Vendosja sipas radhës:
_____	1. _____
_____	2. _____
_____	3. _____
_____	4. _____
_____	5. _____
_____	6. _____
_____	7. _____
_____	8. _____
_____	9. _____
_____	10. _____

